

VLERÄ

REVISTË PËR FAMILJE DHE SHOQËRI

**Kur feja
bëhet adet**
fq 3

fq 23

**Mrekullia e Zotit
për numrin 19
në Kur'an**

**Me rastin
e varrimit
të Fatimes.**
fq 6

**101
Këshilla
Martesore**
fq 34



KUR FEJA BËHET ADET

FQ 3



ME RASTIN E VARRIMIT TË FATIMES

FQ 6



KËSHILLA PËR GRATË E LËNDUARA

FQ 20



MREKULLIA E ZOTIT PËR NUMRIN 19

FQ 23



101 KËSHILLA MARTESORE

FQ 34

KRYEREDAKTORE:

H.Ikballe Berisha Huduti

ikballebh@gmail.com

www.ikballebh.com

Mob: +377 44 142 038

REDAKTORE:

Ardiana Ismaili

REDAKSIA:

Mr. Iris Robaj

Dr. Emine Goxhuli

Fehmi Maliqi

Zehra Huduti

Arlinda Hashani

Mr. Arbër Berisha

Dafina Berisha

Adelina Rama

DESIGN:

MM

ADRESA:

Rr.Rrustem Statovci 25

Prishtinë 10000

E-mail: vlere.magazine@gmail.com

www.revistavlera.com

Botoi: Shtëpia Botuese

"Dielli Pas Reve"

044/043 509 700

Print: Roto Print

Tirazhi: 2000 copë

SPONSORED BY:

THE
WORLD
FEDERATION
OF KHOJA SHIA ITHNA-ASHERI MUSLIM COMMUNITIES





Kur feja bëhet adet

Në vend të editorialit

Bismilahir-Rahmanir-Rahim - Në emër të Allahut Mëshiruesit Mëshirëbërësit!

**Çfarëdo e mire që të vjen është nga Allahu,
e çfarë të ndodhë nga ndonjë e keqe është nga vetë ti...**

NISA 47

Ikballe Berisha Huduti

“Shehadeti (martirizimi) i Imam Husejnit ishte e mirë e Allahut të Lartësuar, ndërsa ligësia dhe e keqja që bëri Jezidi ishte nga vetja e tij !

Një veprim adhures siç është për shembull sexhdja gjatë namazit në të cilën lexohet kjo fjali, **“subhane rabel eala ve bihamdik” - “Madhështia është e të Lartësuarit dhe Atij i takon falënderimi”**, në vete përmban vlerë dhe motiv shumë domethënës ngaqë namazliu në një gjendje krejtësisht për toke i shtrirë dhe i bindur Allahut, e lavdëron madhështinë e Tij duke e falënderuar Atë e duke u nënshtruar dëshirës së Tij me atë pamje përkushtimi drejt tokës ku dëshmon se “Ja ku jam o Zoti im, jam shtrirë në tokë para madhësisë tënde, ngaqë unë jam një hiç i pavlerë po mos të besoja Ty, po mos të përulesha para Teje me frikë dashurie për Ty.” Pra namazliu i vërtetë nuk i përulet Zotit ngaqë i frikësohet Atij, por vetëm për të treguar vogëlsinë e tij ndaj madhësisë dhe fisnikërisë të të madhit Zot, e nga ana tjetër me ato rituale dhe ibadete ai i është mirënjohës Krijuesit të tij që mirënjohësit i shpërblen me shumë të mira në besim dhe në jetën e tyre.

Të gjitha veprimet adhures që ne i bëjmë në jetë, qoftë namazi, agjërimi, shkuarja në haxh e shumë punë tjera në vete paraprakisht kanë një taklid pra imitim, që ne i kryejmë sipas udhëzimeve të dhëna nga Pejgamberi paqja qoftë mbi të

dhe familjen e tij dhe pastaj nga ky imitim i përditshëm pa argumentim ose së paku pa e ditur kuptimin e atyre fjalëve në sexhde, apo pa e ditur domethënien e sexhdes, pa e verifikuar atë ritual apo vepër adhurimi, neve çdo gjë na bëhet rutin dhe fillojmë të mos e ndiejmë lezetin, kënaqësinë e përlules, sexhdes apo bisedimeve me Zotin. Kjo ndodh ngase numër një, ne nuk e kemi kuptuar domethënien e atij lartësimi dhe falënderimi në gjuhën tonë amtare, e së dyti edhe në atë kohë të vogël të namazit qoftë 5 apo 10 minuta ne nuk jemi në gjendje t'i përjashtojmë nga mendimet tona të gjitha ngarkesat dhe problemet materiale të kësaj jete. Me një hadith Kudsi Zoti i ankohet robërve të Tij duke i këshilluar që së paku në ato pak çaste t'i kushtohet plotësisht Zotit e jo dynjasë dhe mashtrimeve të saja. Të gjitha veprimet e përsëritshme qofshin brenda namazit apo jashtë namazit janë në thelb veprime të mira, por kur këtyre veprimeve i humbet përsëritsh mëria dhe këto veprime apo vepra të mira kalojnë në rutinë apo siç thotë fjala e popullit bëhet adet, e ky adet ndonjëherë aq shumë zbehet sa që vepra e përsëritshme, këtë rast po e marrim si shembull namazin, bëhet aq e paefekt, aq jo ndikuese në zemrat tona, me shumë pak koncentrim në atë çfarë e themi e kështu me radhë, kështu që vije në një shkallë aq të ulët sa që humbet përkushtimi shpirtëror. Kur humbet përkushtimi shpirtëror në veprat tona qoftë namazi ose veprat tjera të mira, atëherë ajo vepër adhurimi, qoftë namazi apo agjërimi, zbrazen nga efektet e ndritura shpirtërore ku më pastaj ajo

zemër ngushtohet, humb ndriçimin shpirtëror, sa që bëhet vetëm një copë muskuli por në brendësi është e zbrazët e ftohtë e humbur dhe pa dritë. Kur zemra ndjen këtë zbrazëti pa marrë parasysh çfarë është nga aspekti fizik i përmban të gjitha mundësitë e bukura dhe luksoze, por nga aspekti shpirtëror ajo mbetet e zbrazët e ftohtë ngase kur humbet drita ajo vetvetiu mbushet me errësirë.

Mbushja e zemrës me errësirë dhe ligësi siç ishte zemra e Jezidit i cili ishte halif (udhëheqës) i muslimanëve, bile bile i udhëhiqte namazet e xhumasë, por nga ana tjetër zemra e tij u mbushur me errësirë e ligësi ndaj islamit që predikonte nipi i Pejgamberit s.a.a , e bëri që të urdhërojë 14.000 ushtarë të cilët gjithashtu ishin musliman të njëjtë si Jezidi, që të ngrenë shpatat kundër anëtarëve dhe pasuesve të Familjes së Pejgamberit s.a.a., ngase zemrat tyre ishin të errësuara edhe pse falnin namazin, ishin të liga edhe pse agjëronin Ramazanin, ishin të djallëzuara edhe pse rrinin karshi Qabesë ishin të errëta ngase në errësirë nuk mund të mbijetojë drita e në ligësi nuk mund të mbijë e mira. Me një fjalë, zemra e Jezidit birit Muaviut u zbraz nga Drita e Tij ,atëherë ajo zbrazëti e krijuar u mbush me të këqija dhe ligësi.


Lus Zotin e Lartësuar që ibadetet (veprat adhuruese) tona të na mbushin zbrazëtirat tona të zemrës me Dritën e Tij, që të na mbulojë Drita mbi të gjitha dritat, Drita e Tij të jetë pranë të gjitha zemrave të ndritura deri në Ditë të Kiametit në mënyrë që mos t'i lëmë vend errësirës dhe ligësisë së mundshme që mund të paraqitet te besimtarët e mos kujdesshëm.

Ky ajet i mrekullueshëm Kuranon më frymëzoi ta shkruaj këtë shkrim duke u korresponduar me shpjegimin, komentimin e bukur të këtij ajeti nga Alama Taba Tabai. Sipas ajetit “Çfarëdo e mire që të vjen është nga Allahu, e çfarë të ndodhë nga ndonjë e keqe është nga vetë ti“

Një pjesë e muslimanëve ia etike:"tojnë Shehadetin (vdekjen e Imam Husejnit – paqja qoftë mbi të “ Se Zoti ka dashur të bëhet kështu që nipi i Pejgamberit të vdes në Qerbela pa pikë uji së bashku me 48 shehida tjerë.” Këta musliman harruan ajetin kuranor të cekur më lart se “ Se çfarë do që të ndodhë nga ndonjë e keqe, ajo është nga vetë ti, nga nefsi yt”, apo siç thuhet gjithashtu në Kuran sure Bekare 177 “...çdo ligësi buron nga vetët tona dhe kjo nuk mund ti mveshet Zotit” .

Pra, nga njëra anë fatalistët, thonë “ Zoti ka dashur ashtu të vritet Husejni”, ndërsa përkrahësit e Jezidit nuk e kuptojnë peshën e ndodhisë së Qerbelasë por e akuzojnë Husejnin si rebel kryengritës kundër pushtetit të asaj kohe gjatë sundimit të Jezidit birit të Muaviut i cili ia përgatiti fronin e halifatit që ta luftojë Shtëpinë e Sheriati, familjarët dhe më të afërmit e të dashurit të Allahut Muhamedit s.a.a.

Prandaj unë mendoj dhe jam më se e bindur se Jezidi me ligësinë dhe krimin e tij nuk janë pasqyrim i veprave të Zotit, por është vepër e ligë e nefsit të Jezidit. Pra, me një fjalë ajeti shumë mirë na shpjegon se veprat e liga rrjedhin nga vetja jonë, pa marrë parasysh që ne ndoshta edhe bëjmë namaz apo agjërojmë, sepse kur veprat adhuruese pra ibadetet e humbin efektin e vetë ngase nuk veri-



fikohen dhe nuk argumentohen drejt por vetëm punohen sipas udhëzimit të pa verifikuar, “ se kështu ka bërë gjyshi im që e kam pas hoxhë”, etj.

Por, tani në kohët tona bashkëkohore Islami është bërë pronë e hoxhallarëve dhe njerëzit besojnë verbërisht kështu ka thënë filan filan hoxha, e gjithë kjo pra bie në gjendjen e Islamit që e predikonte Jezidi, i cili e pasoi islamin e babit të tij Muaviut, i cili gjithashtu ishte shkas i Shehadetit të Imam Aliut , kështu pra kur ky besim Islam ky namazi ynë bëhet vetëm me të thanëme e jo me të studiuar e me të verifikuar, atëherë këto ibadete bëhen rutinë dhe kalojnë në adete dhe më pastaj nga zemrat tona largohet drita dhe mbetet një zbrazëturë e cila mbushet me errësirë e ligësi dhe i njëjti namazli siç ishte edhe Jezidi nuk e ka të vështirë të e bëjë ligësinë ngaqë feja e tij tani më iu është bërë rutinë, adet e pa kurrfarë kuptimi të vërtetë bile bile vret e zhvaret. Feja pra vret e zhvaret sepse më pastaj bëhet adet (zakon) i Jezidit dhe motos së tij që nuk gjendet askund në Kuran por gjendet në gojë të muslimanëve si kushtet e besimit Islam dhe të thotë atë që edhe mua hoxha im në fëmijëri ma kishte mësuar në xhami e që unë nuk isha razi , - “ Hajrrihi ve sherrihi minallahi teala” që do të thotë - “ Hajri dhe sherri janë nga Zoti “ (fati dhe fatkeqësia janë nga Zoti), duke mos e verifikuar këtë se a e ka thënë Jezidi apo Zoti.


Në fund do të shtoja se nëse ne ndodhisë së Qerbelasë i themi se “Allahu ashtu ka dashur të bëhet”, atëherë me këtë mendim dhe miratim ne e lirojmë nga krimi Jezidin dhe pasuesit e tij. Ndërsa nëse i japim të drejtë ajetit Kuranor, Imam Husejni ishte veprim i dëshirës së Allahut, ngaqë veprat

e mira janë nga Allahu, e Shehadeti martirizimi është shpërblime i madhe për një besimtarë, edhe pse Husejni nuk shkoi për të luftuar, as për të protestuar, sepse ai kurr nuk ishte rebelues, por nuk pranoi urdhrat e liga të Jezidit, ngaqë zemra e Imamis ishte dritë e mëshirë ndërsa ajo e Jezidit ishte errësirë e ligësi.

Imam Husejni nuk shkoi për të luftuar e kjo është mjaftë e dukshme sepse fëmijët nuk merren në luftë, ai pra morri fëmijët e tij, morri foshnjën tre mujore Ali Azgarin që ra shehid, morri sofrën edhe bukën, morri gratë e familjes, mori motrat dhe mbesat e vogla, e la zjarrin e ndezur në vatër, ai e la shtratin e shtrirë të fëmijëve të tij, ai u përshëndet me varrin e gjyshit tij Pejgamber, ai u përshëndet me nënën Fatime pranë varrit të saj. Ai nga Medina në Mekë shkoi për t'u takuar me Shtëpinë e Allahut Qaben e Madhëruar dhe u nis për në shkretëtirën e nxehtë të Qerbelasë së bashku me familjen e tij me gra e fëmijë për të migruar e jo për të derdhur gjakun e muslimanëve që trupin ia copëtuan.

Imam Husejni mërgoi sepse mbante në vete mesazhin Hyjnor që ishte ideali i tij i shenjtë, ai ishte i gatshëm të vdesë sepse këtë ideal e shihte si mirësi për gjithë njerëzinë. Ai nuk guxoi t'ia bëj nder Jezidit që përmes besimit të Husejnit ai të keqpërdorë këtë mesazh Hyjnor. Prandaj Imam Husejni paqja qoftë mbi të (a.s) shehadetin (martirizimin) e shihte si reflektin e të mirës së Zotit që erdhi nga Ai, pra:

Ma esabeke min hasenetin feminallahi ...“ , “ Çdo e mirë që të vjen është nga Allahu....”



Raste të dhimbshme për Aliun

me rastin e varrimit të gruas së tij



Ajo që Prijësi i besimtarëve ka deklaruar me rastin e varrimit të Fatimes, më të Mirës nga femrat – Alejhiselami! – gjersa i ishte drejtuar Pejgamberit Famëlartë në varrin e tij.

O Pejgamber i Allahut, selami i Allahut qoftë mbi ty nga unë dhe nga bija jote e cila erdhi afër teje dhe e cila nxitoi të takohet me ty ! O Pejgamber i Allahut, durimi im rreth zgjedhurës tënde u sos dhe fuqia ime e qëndresës u dobësua; mbeti vetëm ngushëlimi nga pikëllimi i madh i pësuar dhe ngjarjen e hidhur të ndarjes tënde, me atë se të kam lëshuar në varrin tënd edhe me atë që shpirti yt ka kaluar nëpër qafën dhe gjoksin tim.

Vërtet të Totit jemi dhe te Ai do të kthehemi.

(Kuran 2:156)

Kurse tani huaja u kthye dhe ajo që është dhënë u morr prapa Pikëllimi im është i përherëshëm. Kurse sa i përket netëve të mia, ato do të mbesin të pagjumë gjersa Allahu nuk do të caktojë për mua shtëpinë në të cilën jetoni ju tani.

Natyrisht, bija jote do të lajmërojë se ithtarët tu janë bashkuar për shkak të tiranizimit (shtypjes) së saj. Pyete për çdo gjë dhe mëso të gjitha lajmet mbi gjendjen. Kjo ndodhi kur nuk kishte kaluar as kohë të gjatë, as kujtimi për ty. Selam keni të dytë nga i cili përcjell, ejo nga personi i cili urren dhe ndjen mërzi, ngase nëse shkoj, kjo nuk do të jetë nga mërzia, kurse nëse mbetem kjo nuk do të jetë për arsye se dyshoj në atë që Allahu u ka premtuar durimtarëve.

Marrë nga libri “Nehxhul Belaga- Shtegu i Elokuencës”, mblodhi Essejjid Asharif Erradi , botoi” Bashkësia Islame “ Ehli Bejt” 1998, Fjalimi 201, fq. 2016.



Njohja e shpirtit

Autor : Ajetullah Hasan Hasanzade Amoli

I Dërguari i Zotit, (paqja qoftë mbi të dhe familjen e tij) thoshte: “Njihe shpirtin tënd, do ta njohësh Zotin tënd”. Sipas fjalëve të Imam Aliut (pqmt): “Njeriu është një botë e madhe ndërsa në botën ku ai jeton, ajo është një botë e vogël”. Në filozofinë dhe urtësinë fetare qëndron mendimi se arritja e njohjes njerëzore është hap nga njohja e të Vërtetës. Të njohësh njeriun do të thotë të njohësh shpirtin e tij. Prandaj, filozofia religjioze si bazë të shkencës së saj ka për qëllim shqyrtimin e çështjes së ekzistencës. Të merresh me problemin e ekzistencës, do të thotë ta njohësh njeriun si manifestim më i lartë i krijimit të Zotit. Për filozofinë islame, njeriu është qenie në të cilin më së miri dhe në mënyrën më të qartë manifestohet krijimi hyjnor. Njeriu është manifestimi më i plotë i Ekzistuesit të Domosdoshëm, e Atë është më së lehti ta njohim përmes njohjes së qenies njerëzore.

Fakte dëshmi për ekzistencën e Zotit

Ekzistenca (vuxhud) është diçka për të cilën mund të dëshmojmë. Ne vetë ekzistojmë dhe ekziston çdo gjë që na rrethon. Ne në të vërtetë nuk jemi asgjë jashtë ekzistencës; ekzistencën në çdo vend e shohim dhe e takojmë. Ekzistenca është të qenurit apo të ekzistuarit tonë. Në të kundërtën e kësaj, qëndron mosekzistenca dhe mosqenia (a'dam). Mirëpo, duke pasur parasysh se mosekzistenca e asgjësë, bën fjalë për mosqenien (mosekzistencën) për diçka që nuk mund të dëshmosh, atëherë çdo diskutim mund të na ndërgjegjësojë në atë se si mund të bëhet fjalë për diçka që është në kundër-

shtim me ekzistencën, pra që nuk ekziston. Prandaj, ekzistenca është burimi i shkakut dhe çdo gjë që është emanente, bëhet dhe ndodhet për shkak të ekzistencës e jo nga mosekzistenca. Mendoj se është plotësisht e thënë dhe e qartë. Shkurtimisht, nuk ekziston asgjë po të mos ishte ekzistenca, çdo gjë është ekzistencë dhe çdo gjë vjen nga ajo. Paraprakisht po vazhdojmë me atë që e thamë më lartë, po i vështrojmë tani nocionet, atë komponent me të cilën ne dëshmojmë, pastaj të shohim se a ka ndonjë dallim kualitativ. Po shikojmë që ai komponent a dallohet nga efektet e ekzistencës së saj.

Grupet dhe llojet e krijesave

Ekzistojnë gjëra për të cilat ne dëshmojmë, e të cilat së paku në shikim të parë nuk posedojnë aftësi lëvizëse as ndonjë aftësi ndjesie, për këto gjëra nuk ekziston asnjë përparim apo zhvillim. E kështu është toka, shkëmbinjtë ose mineralet. Ekziston edhe grupi tjetër i ekzistencës, e cila së paku në një masë të caktuar posedon, lëvizjen, ndjesinë, përparon dhe zhvillohet, këto pra janë bimët dhe produktet tjera bimore. Nëse i krahasojmë këto dy grupe atëherë shohim se ekzistenca e të dy grupeve në esencë është e përbashkët. Relativisht do të vijmë në përfundim se edhe bimët edhe mineralet kanë karakteristika për nga masa dhe vëllimi. Më në fund, do të vërejmë se tek bimët ekziston procesi i rritjes ose zhvillimit, madje posedojnë dhe një masë të ndjeshmërisë për të cilën mineralet e kanë si mungesë. Në bazë të këtyre vëzhgimeve, bimën do ta vendosim në një vend më të lartë në krahasim me mineralet.

Gjithashtu ekziston edhe grupi tjetër, përkatësisht qeniet që janë shumë të lëvizshme, ku ndjeshmëria e kësaj qenie është më e lartë sesa e bimëve dhe ajo qenie shfaq veprime të ndryshme që vijnë nga dëshira e saj. Në këtë grup marrin pjesë krijesa të ndryshme tokësore dhe kafshët detare. Nëse e krahasojmë këtë grup me grupin e bimëve, do të shohim se të dyja i ngjasojnë ekzistencës, pra posedimit të trupit, aftësinë për t'u rritur e zhvilluar, nevojën e të ushqyerit, mirëpo më tutje do të vërejmë se kafshët dallojnë me cilësitë që bimët nuk i posedojnë, siç është instinkti apo dëshira, shqisat, fuqinë dhe cilësitë e ngjashme. Pra efekti i ekzistencës tek kafshët është më i madh sesa te bimët, që do të thotë se kafshët janë në një shkallë më të lartë të ekzistencës.

Tani arritëm tek grupi tjetër i radhës i cili posedon të gjitha cilësitë e ekzistenciale të kafshës. Pra cilësinë e rritjes, zhvillimit, veprimit, por shkalla ekzistenciale e këtyre krijesave është më e lartë

nga kafshët. Tani do të shohim se si mineralet, bimët dhe kafshët janë në një pozitë të caktuar në krahasim me këtë krijesë. Kjo krijesë e mrekulueshme është njeriu.

Tani do të shkojmë në vështirime të mëtejme të këtij grupi të krijesave, do të vërejmë se efektet e një njeriu të ditur janë më të mëdha se i një të padituri. Për shembull, të gjitha shpikjet dhe zbulimet janë fryte të dijetarëve e kurrsesi të të paditurve. Pra, i padituri apo injoranti është në një pozitë të caktuar në krahasim me të diturin. I dituri është mbi njeriun e paditur, kafshët, bimët dhe mineralet. Në të vërtetë, dituria është një burim që njeriut i jep përparësi dhe ajo është mbi të gjitha.

Emri i autorit: Hasan Hasanzade Amoli

Emri i librit: "Znanje o duši"

Botues: Naučnoistraživački Institut "Ibni Sina",

Sarajevë 2002

Përktheu nga gjuha boshnjake: Ikballe Berisha Huduti



Parimi i Marteses

në Univers

"Dhe Ne krijuam prej
çdo sendi dy lloje
(mashkull e femër)
që ju të përkujtoni
(madhësitinë
e Zotit)."

[Kur'ani i Shenjtë, 51:49].

Sistemi i bashkimit dhe çiftimit të lënda e pajetë

All-llahu, me mençuri dhe me urtësi, ka dëshiruar që çdo gjë ta krijojë në çifte në rendin e qëndrueshëm dhe ekstensiv të Krijimit. Në skenën expansive të krijimit çiftimi i çdo gjëje është një e vërtetë absolute, pa asnjë përjashtim. Edhe para se njeriu të arrinte ta mësonte këtë fakt me anë të dijes së tij dhe të kryente kërkime shkencore për të, Kuran i Madhëruar e ka bërë të njohur këtë të vërtetë në ajete të shumta, duke përfshirë edhe ajetin 49 të sures së bekuar me titull **"Erërat shpërndarëse (Edh-Dharijat)"**. Ky fakt shkencor përfshin gjithçka në Krijim, duke përfshirë objektet e pajeta, bimët, shtazët dhe njerëzit.

Njeriu dhe martesë

Çiftimi, mbarsja dhe riprodhimi në botën e objekteve të pajeta, të bimëve

dhe kafshëve bazohen në rregullat e Krijimit dhe mënyrën korrekte të instinkteve. Kjo çështje jetike dhe ky program natyror madhështor megjithatë duhet të kryhet dhe të bazohet mbi rregullat hyjnore, mbi ato rregulla qiellore të theksuara në Kuran dhe në thëniet hyjnore të Pejgamberëve dhe Imamëve (udhëheqësve hyjnorë). Përbërësit bazë të këtij fakti (të martesës) janë vendosur te burri dhe gruaja në formën e instinkteve, tërheqjes, miqësisë, dashurisë dhe mirësisë dhe janë rregulluar sipas dëshirës së urtë të Zotit.

"Dhe nga faktet (e madhërisë së) e Tij është që për të mirën tuaj, Ai krijoi nga vetë lloji juaj palën (gratë), ashtu që të gjeni prehje tek ato dhe në mes jush krijoi dashuri dhe mëshirë. Në këtë ka argumente për njerëzit që mendojnë."

[Kur'ani i Shenjtë, 30:21]

"Dhe Ai nga uji (fara) krijoi njeriun, dhe e bëri atë të ketë fis dhe të ketë miqësi. Zoti yt ka mundësi të jashtëzakonshme."

[Kur'ani i Shenjtë, 25:54]

Në kulturën e papërlyer islame, veprimi i zgjedhjes së bashkëshortit rekomandohet dhe admirohet fuqimisht si një program i shkëlqyer. Nëse të qenët i pamartuar mund ta çojë dikë deri në kryerjen e mëkateve, është absolutisht e detyrueshme që ai të martohet. Në këtë

pikë, çdokush duhet ta zbatojë me gjithë zemër urdhrin e Zotit në lidhje me martesën dhe nuk duhet të frikësohet për shpenzimet që përfshin ajo, pasi shqetësimi në lidhje me shpenzimet e jetesës në të ardhmen është një mendim djallëzor që rezulton nga dobësia mendore dhe që nuk mbështetet në dëshirën e Zotit. Tani le të shqyrtojmë ajetin e mëposhtëm kur'anor nga kapitulli Nur, në lidhje me martesën dhe garancinë e Zotit për të siguruar shpenzimet jetësore:

“Dhe martoni të pamartuarat (të pamartuarit) edhe robërit e robëreshat tuaja që janë të ndershëm e të ndershme. Nëse janë të varfër, All-llahu i begaton nga mirësitë e Tij, All-llahu është bujar i madh, i gjithëdijshëm.”

[Kur'ani i Shenjtë, 24:32]

Fjalë për fjalë, "martoni" në këtë ajet është një urdhrë që iu adresohet të gjitha burrave dhe grave të shoqërisë. Nga ky ajet çdokush mund të konkludojë se martesa është e domosdoshme për ata që kanë nevojë për t'u martuar, pasi përndryshe shëndeti dhe dëlirësia e tyre do të rrezikohet. Ajeti gjithashtu shërben për t'i udhëzuar prindërit, dhe ata që mund t'i paguajnë shpenzimet e dasmës, që t'i martojnë të rinjtë dhe të rejat.

Jini dashamirës në bërjen e përgatitjeve për martesë

Është një çështje e natyrshme, njerëzore dhe jetike që burrat të tërhiqen nga gratë dhe anasjelltas, veçanërisht kur sythat e instinkteve çelin dhe lulja e epshit shfaqet në shkallën dhe fuqinë e saj më të lartë, në kohën kur njeriu është për martesë. Martesa është një çështje e pamohueshme për të gjithë. Dëshira e drejtë e të rinjve, qofshin ata djem apo vajza, në lidhje me të ardhmen e krijimit të një jete martesore është një e vërtetë e qartë. Kjo e vërtetë është e qartë si dielli që ndriçon në mes të ditës për të gjithë, veçanërisht për prindërit të cilët kanë fëmijë në moshën e martesës.

Mënyra më e rëndësishme dhe më e mirë për t'i parandaluar mëkatet dhe për ta mbrojtur shoqërinë nga rënia në vorbullën e korrupsionit është martesa e të rinjve dhe të rejave, kur ata kanë nevojë për t'u martuar. Kjo nuk mund të mohohet nga askush, përveçse nga të paditurit dhe injorantët. Duke u bazuar në diskutimin e mësipërm, gjatë

fazës së parë të këtij bashkimi, prindërit, të afërmit dhe çdokush tjetër që ka lidhje me martesën e çiftit, duhet të jenë dashamirës në përgatitjen e lehtësive për këtë çështje hyjnore. Ata duhet t'i bëjnë rregullimet e dasmës në mënyrën më të thjeshtë të mundshme. Në fazën e ardhshme është e nevojshme që burri dhe gruaja që planifikojnë të martohen t'i shmangin premtimet pa vend ndaj njëri-tjetrit. Po ashtu, ata duhet ta shmangin krijimin e kushteve të rrepta për martesë, ashtu që prirjet, instinktet, epshi dhe dëshirat të mund të ndjekin me lehtësi rrugën e tyre natyrale dhe që themelet e jetës të vendosen me mbarësi. Kështu, ndërtesa e suksesit do të lartësohet në këtë botë dhe në botën tjetër.

Prindër lehtësoni martesat e mos i vështirosni!

Sipas haditheve dhe ajeteve kur'anore, pa dyshim Zoti Mirëdashës do të jetë dashamirës në këtë botë dhe veçanërisht në botën tjetër për sa u përket veprave të atyre që janë dashamirës në lidhje me çështjet e tyre, sidomos me veprat që lidhen me martesën e bijve dhe bijave të tyre. Nga ana tjetër, burrat dhe gratë që janë shumë të rreptë do të bëjnë që pasardhësit e tyre të vuajnë nga sëmundje nervore dhe psikike dhe të bëhen me karakter të keq, për shkak të presionit të instinkteve dhe epshit. Këta të pafajshëm mund të kryejnë mëkate dhe shpresat dhe dëshirat e tyre do t'i marrë era. Në këtë botë dhe veçanërisht në Botën e Përtejme, Zoti do të jetë i rreptë dhe i zemëruar me ta dhe ata do të digjen në zjarrin e zemërimit të Zotit. Të qenët tepër i matur në lidhje me martesën do të bëjë që njeriu të bëhet shumë i rreptë. Bashkimi i një çifti në natyrë bëhet jashtëzakonisht me lehtësi. Ky sistem superior padyshim nuk do të mund të ekzistonte tani nëse procesi i kombinimit dhe çiftimit në natyrë do të ishte i vështirë.

O ju prindër dhe fëmijë! Mos u bëni tepër të rreptë në lidhje me përgatitjet për këtë bashkim hyjnor dhe human, në përcaktimin e dhuratës martesore, në përcaktimin e kushteve të martesës, në organizimin e ceremonisë së fejesës, ceremonisë fetare dhe ceremonisë së dasmës. Mos u bëni shumë të rreptë në lidhje me kryerjen e zakoneve lokale dhe mos propozoni plane të cilat janë përtej mundësive financiare të dy familjeve. Kryejeni martesën me lehtësi që Zoti Mirëdashës t'ua lehtësojë punët tuaja në këtë botë dhe në botën tjetër. Prandaj, praktikoni mënyrat e të devotshmëve dhe merrni leksione nga ky burim përfitimesh dhe bekimesh. Dhe ndërtojeni jetën tuaj duke u bazuar mbi karakteristikat e të devotshmëve, pasi lumturia dhe të mirat e kësaj bote

dhe të botës tjetër janë për ata që ndjekin shembullin e të dashurve të Zotit të Përvetshëm.

Rastet e mëposhtme nuk janë shenja të dinjitetshme: dhuratat tepër të shtrenjta martesore; ceremoni të shtrenjta; gosti me shumë të ftuar; ndjekja e zakoneve dhe traditave të palogjikshme dhe të papërshtatshme dhe imponimi i kushteve të rrepta. Ndërsa këto që vijojnë janë akte dinjitoze: çifti duhet të përputhet me njëri-tjetrin sipas rangut; të dyja familjet duhet t'i binden etikës islame; burri dhe grua duhet t'i respektojnë të drejtat hyjnore dhe njerëzore; të dy partnerët duhet të vazhdojnë të jenë të dashur dhe të sjellshëm për vazhdimin e martesës dhe për të shmangur grindjet.

Në fakt, martesë çmohet shumë në Islam dhe ajo është jashtëzakonisht e dobishme për burrin dhe gruan. Shpresojmë se familjet do ta lehtësojnë këtë çështje humane, hyjnore dhe të rëndësishme dhe do të abstenojnë nga bërja e kushteve të vështira për t'u përmbushur dhe se do të jenë më dashamirës. Dhe shpresojmë se ata do t'i kryejnë këto ceremoni në bazë të statusit të tyre social, duke u kënaqur me atë që kanë në dispozicion. Kështu që dëshirat e të rinjve do të përmbushen në mënyrë të natyrshme dhe instinktet e tyre, duke u dhënë nga Zoti si bekime, nuk do të kthehen në mëkate.

Martesa e Imam Aliut me Hazreti Fatimen

Jeta e një çifti si ajo e kalifit të besimtarëve (Imam Aliut) dhe Fatimes (paqja e Zotit qoftë mbi të dy) është modeli më i mirë për çdo burrë dhe grua muslimane. Fatimja ishte burimi i paqes për burrin e saj, duke krijuar një ambient të qetë në shtëpi dhe Aliu (paqja e Zotit qoftë mbi të) ishte një model dhe një mësues i shkëlqyer për fëmijët dhe një ndihmës i këndshëm në punët e shtëpisë dhe familjes. Ai nuk ngurronte të ndihmonte në çështje të thjeshta rreth shtëpisë si: pastrim, përgatitjen e brumit të bukës dhe të ndihmonte në kujdesin për fëmijët. Ai nuk e linte gruan e tij që të lodhej në bërjen e punëve të shtëpisë dhe nuk e linte atë të bënte gjithçka rreth shtëpisë. Është e obligueshme për burrin dhe gruan që t'i respektojnë të drejtat e njëri-tjetrit dhe të jenë ndihmëtarë të njëri-tjetrit në të gjitha aspektet e jetës. Çdo akt i padrejtë që i dëmton të tjerët është shtypja dhe Zoti nuk e pëlqen shtypjen dhe shtypësin. Ai nuk e pëlqen çdo shkelje të të drejtave të tjetrit, sado e parëndësishme qoftë. Në vijim do të citojmë, nga burime autentike, disa thënie të rëndësishme në lidhje me vlerën dhe rëndësinë e martesës dhe dobitë e saj.





Thënie mbi vlerën dhe rëndësinë e martesës

Pejgamberi (s.a.a.) ka thënë:

"Mëshira dhe përkujdesja e Zotit do t'i dhurohet njeriut në katër situata: kur bie shi, kur një fëmijë kujdeset me mirësi për babanë e tij/saj, kur dera e Qabesë (Shtëpisë së Zotit) është e hapur dhe kur hartohet një kontratë martesë dhe dy njerëz bashkohen me njëri-tjetrin në një jetë të re." [Martesa në Islam, f. 17]

Pejgamberi (s.a.a.) ka thënë:

"Ju duhet të martoheni dhe t'i martoni bijat dhe bijtë tuaj të pamartuar. Shenjë e prosperitetit të një muslimani është të paguajë shpenzimet që të martohet me një grua. Dhe asgjë nuk pëlqehet më shumë nga Zoti se sa një shtëpi muslimane që pasurohet nga martesa." [Martesa në Islam, f. 7]

Pejgamberi (s.a.a.) ka thënë:

"Martojini djemtë tuaj të pamartuar derisa vullneti i Zotit t'i bëjë ata të përmbajtur dhe ta shtojë bukën e gojës së tyre të përditshme, si edhe shpirtmadhësinë e tyre." [Martesa në Islam, f. 8]

Pejgamberi (s.a.a.) i Shenjtë i Zotit ka thënë:

"Martesa është praktika ime dhe kush largohet nga ajo nuk i përket umetit tim." [Bihar al-Anvar, v.103, f.222.]

Pejgamberi (s.a.a.) ka thënë:

"Kushdo që martohet e ka plotësuar në fakt gjysmën e fesë së tij dhe [për të

plotësuar] gjysmën tjetër ai/ajo duhet të jetë i devotshëm."

[Bihar al-Anvar, v.103, f. 219.]

Imam Sadiku (paqja e Zotit qoftë mbi të) ka thënë:

Një burrë erdhi tek im atë, Imam Bekiri. Babai im e pyeti nëse ishte i martuar, ndërsa burri i tha 'jo'. Pastaj babai im i tha atij se ai nuk do ta donte të gjithë botën me gjithçka në të, që të mos jetonte një natë pa gruan e tij. Pastaj babai im vazhdoi duke thënë se dy rekate lutjeje të një njeriu të martuar janë më të mira se një natë adhurimi dhe një ditë agjërimi të një njeriu të pamartuar. Pastaj babai im i dha burrit shtatë derhemë dhe i tha atij që të blinte gjërat e nevojshme për martesë me këto para, pasi Pejgamberi (a.s.) ka thënë: "Zgjidhni një bashkëshort dhe kjo do të shkaktojë shtimin e bukës suaj të përditshme." [Vasa' il al-Shiia, v. 14, f. 7]

Pejgamberi (s.a.a.) ka thënë:

"O të rinj! Kush prej jush ka mundësi të martohet le të martohet, ashtu që rrallë t'i shohë gratë e tjera dhe të mbetet pa mëkate." [Martesa në Islam, f. 14]

Pejgamberi (s.a.a.) ka thënë:

"Asnjë kontratë në Islam nuk është më e aprovuar nga Zoti se sa martesa." [Bihar al-Anvar, v.103, f. 222]

Pejgamberi (s.a.a.) ka thënë:

"Kush martohet ka fituar gjysmën e prosperitetit." [Mustadrak el-Vasa' il, Kapitujt hyrës, Kap.1]

Pejgamberi (paqja e Zotit qoftë mbi të) ka thënë:

"Kushdo që martohet në moshë të re do të bëjë që shejtani të bërtasë dhe të thotë se: 'ai që u martua shpëtoi dy të tretat e fesë së tij nga qasja ime.' Robi i Zotit duhet të mbetet i virtytshëm për të ruajtur një të tretën tjetër." [Bihar al-Anvar, v.103, f. 221]



A i duhet njeriut të sotëm, të ketë një muxhtehid (mësues) të kohës?



Autor: Allaame Tabatabai

Mësimi dhe ligjërimi në Islam

Nxënia e dijes është detyrë fetare në Islam. Pejgamberi ka thënë: “Të kërkohet dija është detyrë e çdo muslimani.” Sipas haditheve plotësisht të themel-uara, të cilat e sqarojnë kuptimin e kësaj thënieje, dija këtu do të thotë tri parimet e Islamit:

1. Bashkimi ose tavhidi;

2. Pejgamberia ose nubuvvati; dhe

3. Eskatalogjia ose ma’adi.

Përveç këtyre parimeve, prej muslimanëve pritet të nxënë dije të dorës së dytë dhe hollësitë e urdhërave dhe të ligjeve të Islamit sipas rrethanave dhe nevojave të tyre individuale.

Është e qartë se nxënia e njohurive të parimeve të religjionit qoftshin ato edhe në formë të përmbledhur, është e mundshme deri në një shkallë për secilin. Por nxënia e dijes së hollësishme të urdhërave dhe të ligjeve të religjionit përmes përdorimit të dokumenteve themelore të Librit dhe të Sunetit dhe rezonimi teknik

për ato (ose ajo që quhet juris-prudencë demonstrative, fikh-i istidlali) nuk është e mundshme për gjithësecilin musliman. Vetëm disa njerëz kanë kapacitetet për demonstrimin e juris-prudencës, as që kërkohet prej çdokujt nxënia e njohurisë së hollësishme, sepse në Islam nuk ka urdhra që kërkojnë të bëjë njeriu përtej mundësive të tij.

Prandaj, studimi i urdhërave dhe ligjeve islamike përmjet rezonimit është kufizuar përmes parimeve të “domosdosë së mjaftueshme” (vaxhib-i kifa’i) për ata individë që kanë aftësinë e nevojshme dhe janë të nevojshëm për studim të tillë. Detyra e pjesës tjetër të njerëzve, sipas parimit të përgjithshëm të domosdosë së injorantit që varet nga ai që di, është të kërkojë udhëzim nga njerëzit e aftë dhe të nevojshëm për të mësuar, të cilët quhen muxhtahidë dhe fakihë. Ky akt i të vijuarit të muxhtahidit quhet imitim ose taklid. Natyrisht, ky imitim dallon nga imitimi në parimet e njohurisë së religjionit i cili është i ndaluar sipas vetë tekstit të Kur’anit,

“(O njeri) mos vijoni atë për të cilën nuk keni dijeni.” (Kur’ani 18: 36).

Duhet të dihet se Islami Shiit nuk lejon imitim të një muxhtahidi të vdekur. Kjo do të thotë, di-

kush që nuk di përgjigjen e një problemi përmes ixhtihadit dhe përmes detyrës fetare duhet të imitojë një muxhtahid të gjallë dhe nuk mund të varet nga pikëpamja e një muxhtahidi i cili nuk është më gjallë, përveç nëse e ka marrë atë udhëzim derisa ai muxhtahid ka qenë gjallë. Kjo praktikë është një ndër faktorët i cili e ka mbajtur jurisprudencën shiite islamike të gjallë dhe të freskët gjatë shekujsh. Ka individë të cilët vazhdimisht vijnë rrugën e gjykimit të pavarur, të ixhtihadit, dhe gërmojnë problemet e jurisprudencës prej një brezi në tjetrin.

Në sunitizëm, si rezultat i konsensusit të mendimit (ixhma) që u paraqit në shekullin IV/X, që konstatuar se ishte i domosdoshëm nënshtrimi njërës nga katër shkollat (e Abu Hanifahut, e Ibën Malikut, e al-Shafiut dhe e Ahmed ibën Hanbelit). Imitimi ose ixhtihadi i lirë i ndonjë shkolle tjetër pos këtyre katërve (ose i një apo dy shkollave më të vogla që u shuan më vonë) konsiderohej e palejueshme. Si pasojë e kësaj, jurisprudenca e tyre ka ngelur në të njëjtën gjendje ashtu si ishte para 1100 vjetësh. Në kohë të fundit disa individë të botës sunitë kanë dalur jashtë këtij konsensusi dhe kanë filluar të ushtrojnë ixhtihad të lirë.

Çfarë duhet të jetë roli ynë në këtë botë



PROF. DR. SHEJH EIDI EKBER

Të gjitha punët të cilat në këtë botë duhet bërë janë të lidhur me katër pyetje themelore të cilat kërkojnë përgjigje:

• **Ër çka jemi në këtë botë?**

• **A kemi ardhur vetë apo na ka sjellë dikush?**

• **Kë duhet pyetur përse jemi këtu?**

A kemi mundësi të zbulojmë përgjigjen për këtë pyetje ose mbase duhet të pyesin dikë? Me fjalë të tjera, cilin duhet pyetur për kuptimin e ardhjes sonë në këtë botë?

• **Çfarë është furnizimi ynë në këtë mision në**

Dynja? Prandaj, çka është furnizimi ynë?

• Cili është qëllimi i misionit tonë? Sepse njeriu nuk e di përse është këtu, me siguri nuk mund të shkojë në Rugë të drejtë, as mund të përgatisë furnizimin në mënyrë të duhur për "udhëtimin" e vështirë.

Kur njeriu nuk e njeh veten, është probabiliteti më i madh që të zhytet në gabime dhe vështirësi. Pikërisht për këtë në Kur'an dhe përgjithësisht në të gjitha librat qiellorë është thënë se njohja më e mirë është njohja e vetvetes. Kur'ani njeriun e trajton në dy mënyra: nga një anë, e trajton si individ me virtyte dhe kualitete të larta, nga ana tjetër, e quan kalif të Zotit ose mëkëmbës në Tokë, gjersa në një vend tjetër thuhet: Ata janë më të prapë dhe se shtazët. Në një vend thuhet se ata tejkalojnë melekët, kurse në një tjetër: **Shembulli i tyre është si shembulli i qenit.**

A është kjo një keqkuptim apo kontradiktë në Kur'an? A e mbështet kjo atë teorinë e fuqisë dhe forcës të Niçes, ku disa duhet të jenë elitë, të cilën e stolisin vetitë më mira, kurse të tjerët duhet të jenë klasë më e ulët, hajvanë – tërheqës.

Ajeti kur'anor thotë: ***Në Adem it ia mësuam emrat e të gjitha gjësendeve.*** Të gjithë këto emra janë përkufizuar në katër operacionet kryesore të matematikës: mbledhje, zbritje, shumëzim dhe pjesëtim. Do të përmendim një shembull: që dikush të hyjë në matematikë dhe të fitojë ndonjë bazë, nevojitet që paraprakisht të njohë këto katër operacione bazë. Vetëm kur të zotërojnë këto operacione, ai hyn në matematikë, sepse tërë matematika bazohet në këto katër shtylla. Po kështu tërë Universi bazohet në emrat e Zotit dhe pa tas nuk mund të hyhet në Univers në mënyrë që të njihet. Ky është kuptimi i këtij rrëfimi.

Nga njëra anë, Kur'ani thotë: Ia mësuam njeriut të gjithë emrat, kurse nga ana tjetër: Mos u bëni si gomarët që bartin libra, pa pasur ide për përmbajtjen e tyre. Madje këtu mendohet edhe për alimët dituria e cilëve nuk prodhon një produkt logjik. Edhe ata janë si gomarët të cilët bartin një grumbull librash, por nuk kanë kurrfarë njohurie të vërtetë për to. Ka dallim drastik midis diturisë nga librat dhe bartjes së librave.

Nga një anë vendoset një korrelacion direkt me Krijuesin, kurse nga ana tjetër ekziston një relacion i çuditshëm i cili është tejet interesant.

Në suren kur'anore El-Me'arixh, prej ajetit 10 deri te ai 14, thuhet:

Dhe asnjë mik nuk pyet për mikun. Edhe pse ata shihen ndërmjet vete (edhe njihen, por ikin prej njëri-tjetrit). Krimineli dëshiron sikur të kishte paguar dënimin e asaj dite me bijtë e vet. Dhe me gruan e vet dhe me vëllain e vet. Edhe me të afërmit e tij që ai te ata mbështetej. Edhe me krejt çka ka në tokë, e vetëm të kishte shpëtuar!
(Arab)

Pra, e shohim se ndonëse njerëzit shihen midis tyre, askush asnjërin nuk e pyet asgjë sepse secili do të jetë i preokupuar me telashet e veta. E kishin pyetur Aishen, bashkëshorten e Pejgamberit, s.a.a: “A do të jenë njerëzit (meshkuj e femra) Ditën e gjykimit lakuriq?” Ajo ishte përgjigjur: “Po, por do të mbretërojë aso frike sa askush nuk do të mendojë lidhur me këtë.”

Diç të ngjashme kemi parë në luftë me Irakun. Qyteti im ishte bombarduar. Njerëzit filluan të iknin. Kur një grup të njohurish tanë u strehuan në një vend të sigurt dhe po pinin çaj, grua e njërit prej tyre tha: “Po unë e paskam harruar fëmijën!”

Ka edhe më keq. Kjo është kur secili për cilin është përgatitur dënimi do të dëshirojë ta flijojë fëmijën e vet për shpëtim nga dënimi, madje edhe gruan, vëllain, dhe familjen e gjerë. Do të ketë edhe të atillë që do të deklarojnë: “le të digjet mbarë bota vetëm të shpëtojë.”

Ajeti pararendës e sqaron mirë hakikatin (realitetin) e insanit. Sepse, nëse njeriu vjen në pozitë që të flijojë gjithçka tjetër për interesin e vet, kjo është sepse e tillë është natyra e tij. Realiteti i njeriut nuk është i tillë vetëm në ahiret, ajo është e tillë edhe në Dynja, vetëm se në Ahiret do të shprehet në mënyrë më eksplicite. Ne atje nuk do të shprehim asgjë që nuk kemi këtu, gjithashtu hadithi i njohur thotë se Dynjaja në të vërtetë është mbjellje për të korrat e ahiretit, pikërisht atë që e mbjellim vetë, d.m.th. atë që e kemi me vete, atë do ta baritim. Me fjalë të tjera, dëshmimi i botës së ahiretit do të tregojë farërat që janë mbjellë këtu.

Fahuridin Raziu, komentuesi i shquar i Kur'anit, thotë; “Si mund të mos e njoh botën e shpirtit këtu, e ta njoh vetëm në Ahiret? Prandaj kam frikë të shkoj nga kjo botë, e të mos e njoh. E si të shkojë në një botë të cilën s’e njohe fare. Si të largohem nga bota e materies në botën shpirtërore kur nuk e kam njohur as botën materiale? Pastaj, si mund ta njohe botën shpirtërore?”



Njeriu dhe gatishmëria e tij për sakrificë

Fatkeqësisht karakteri ynë është i atillë që jemi të gatshëm të sakrifikojmë gjithçka për të plotësuar pasionet.

Nga ana tjetër, kemi rastin e Imam Aliut, a.s., i cili thotë:

“Sikur të më dhuroni gjithçka që shndrit Dielli që t’ia marr një kokërr milingonës, nuk do ta bëja.”

Shohim edhe ajetet kur’anore të cilët pikërisht konfirmojnë këtë natyrë të dyfishtë të njeriut ku, nga njëra anë, kemi njerëz të cilët Kur’ani i trajton si qenie më të larta dhe më të çmuara, kurse, nga ana tjetër, i trajton si qenie të cilët hyjnë në es-felu safirin – qeniet më të ulëta. Jusufi a.s., është paradigmë e mrekullueshme kur’anore të cilin e dimë të gjithë. Ai është persekutuar për shkak të makutërisë së vëllezërve. Të kujtojmë, Jusufin vëllezërit e hedhin në pus si një qenie të pafuqishme, në mënyrë që në fund çështja të ndryshojë tërësisht, Jusufi, a.s., në rolin e dinjitarit, kurse vëllezërit e tij si krijesa të përlurura vijnë tek ai duke e lutur për pak furnizime. Kur vëllezërit arsyetohen para Jusufin, a.s., ai deklaron: *“Nuk ka kurrfarë problemesh, nuk ka mbetur kurrfarë pluhuri në fytyrat tua. Shejtani është ai i cili e krijoi këtë komplot në mes nesh.”*

Kur’ani përmes Jusufit, a.s., citon shembullin e bujarisë islame. Ai ka kaluar mbi kokë të gjitha telashet të cilat ia seruan vëllezërit dhe krejt ua fali me buzëqeshje. Pejgamberin e fundit, s.a.v.a., në rrethanat më të ulëta dhe më të vështira e dëbuan nga Meka, ndërsa kur e pyetën cila është dita më e vështirë në jetën si pejgamber, ai u përgjigj: “Dita në Taifë”, do të thotë dita kur dinjitarët e Taifës i nxitën fëmijët e tyre ta gjuajnë me gurë, ta sulmojnë dhe maltretojnë aq shumë sa edhe sandalet i ishin mbushur me gjak. Mekasit nuk e lejuan të kthehet në qytet tre vjet, kurse në atë kohë humbi gruan Hatixhen dhe xhaxhain Ebu-Talibin.

Me një rast gjatë kohës së luftës me Irakun një grup gjeneralësh i ishte ankuar imam Homeinit (lideri i Revolucionit Islamik në Iran) se nuk mund të duronin më: s’ka ushqim, s’ka armë, kurse ai u përgjigj që të gjitha vuajtjet e luftës nuk mund të futen në një natë vuajtjesh të Pejgamebrit, s.a.v.a.

Pyetja: Në hadith thuhet: *“Asnjë pejgamber nuk ka përjetuar aq vuajtje si unë”*, mirëpo e dimë çka pësoi

Musai, a.s., pastaj Ejubi, a.s., kurse e dimë edhe që Zekerijahun, a.s., e kishin prerë në zgafelle të drurit. Për çka vuajtja e Pejgamberit Muhammed, s.a.aa., është më e madhe se vuajtjet e të gjithë pejgamberëve të tjerë!

Përgjigja: Në bazë të asaj që Muhamedi, s.a.a., nuk duroi vetëm dhembjen e realitetit të vet momental dhe aktual, ai ka parë të gjitha mëkatet dhe musibetet (vuajtjet) e popullit të vet deri Ditën e Gjykitimit, andaj edhe dhembja e tij në proporcion të kësaj ka qenë i shtuar.

Mirëpo, Pejgamberi, s.a.a., pas 13 vite vuajtjesh, durimi intensiv arriti të kthehet në Mekë. Kur hynin në Mekë me Pejgamebrin, s.a.a., sahabët bërtitën: “Sot është dita e hakmarrjes”, kurse Pejgamberi, s.a.a., u tha: “Jo kështu! Ç’keni kështu? Sot është dita e mëshirës!”

Edhe këtu mund të shohim kontrast – njëri është i gatshëm të flijohet për ta shpëtuar veten, kurse nga ana tjetër, personi tjetër në fytyrën e Pejgamebrit, s.a.a., i cili ua falte të gjithëve, madje edhe atyre për të cilët kishte vuajtur gjithë jetën si pejgamber.

Ku janë sekretet e njohjes së vërtetë?

Ta kultivosh shpirtin, në bazë të diturisë së vërtetë, është shenjë e njohjes së vërtetë. Kjo është shumë më tepër se ulja në këndin e dhomës dhe tesbihut. Prandaj, kemi Jusufin, a.s., i cili i kishte falur vëllezërit ndonëse kishte kaluar në burg 30 vjet, sipas disave madje 40 vjet, pa pasur kurrfarë mëkati pos asaj që kishin deklaruar vëllezërit: **“Atë babai nuk e do”**; kurse në fund, Jusufi assesi nuk mund të ishte fajtor, por vetëm babai sepse e kishte dashur më shumë se bijtë tjerë. Mirëpo, pas gjithë vjetëve të vuajtjeve ai vëllezërve smirëzinj lehtësisht u thotë: **“Unë nuk ju akuzoj, tani jeni të pastër.”**

Nëse e zbulojmë sekretin e tërë kësaj, do të kuptojmë si është e mundur që disa njerëz kanë jetë të amshuar, kurse disa janë të vdekur edhe gjersa janë gjallë. Nëse e kuptojmë këtë, do të kuptojmë se edhe ne mund të kemi rol në gjithë këtë. Kjo është një rol pozitiv, i përhershëm dhe me rëndësi jetësore të cilën na imponon jeta.

Ajo që Kurani na transmeton qartë është se ne shkojmë nga kjo botë, kurse veprat tona mbesin dhe ato janë të përhershme dhe të përjetshme. Çdo vepër jona mund të jetë tredimensionale:

- E mirë dhe e përjetshme,
- E përjetshme por e keqe

• As e mirë as e keqe (jeta e njerëzve në këtë botë si shtazë)

Secili prej nesh mund të rregullojë ashtu që të ketë rol pozitiv apo negativ në jetën e vet. Secili mund të marrë vendim në vete dhe për vete duke deklaruar: **“Unë, i cili nuk kam asgjë nga mjetet, përkundër tërë botës, e cila posedon të gjitha armatimet e fuqishme dhe teknologjinë, mund të lë gjurmë dhe shenjë në gjithë atë botë.”** Kur’ani e vë theksin pikërisht në atë që njeriut t’i sqarojë që ai është qenie e përjetshme dhe e fuqishme (shpirtërisht), dhe jo e kufizuar në kohë. Kjo, ndërkaq, përkufizohet në atë si të merret vendimi. Shikoni ajetet të cilët e madhërojnë njeriun dhe ata që e përçmojnë atë! Provoni të numëroni të parët dhe të dytët. Përse disa janë aq të mirë, kurse të dytët të këqij? Dhe si mund të jemi ne nga ata të mirët, dhe të mos jemi nga ata të këqijtë? Nëse e bëjmë këtë, kjo mund të na ndihmojë shumë në jetën e kësaj bote, e të mos flasim për ahiret. Kur ta kemi kuptuar këtë, kurrë nuk do të vijmë në qorrsohak në jetë, sepse ne jemi qenie e kufizuar në arritjet tona fizike, mirëpo e pakufizuar në kualitete tona shpirtërore, sepse Lavdiploti është paskajshmërisht i Fuqishëm dhe i Amshuar.

Pyetje: Nëse kujtojmë ajetet lidhur me hakmarrjen, ku thuhet se për njeriun është më mirë të përmbahet, a do të thotë kjo se edhe ndaj njerëzve të cilët kanë kryer shumë të këqija duhet të jemi të mëshirshëm apo vetëm në rastin kur ftojmë në fë.

Përgjigje: të gjitha sjelljet e Pejgamberit s.a.a., janë legale. Nganjëherë ai është sjellë ashpër ndaj besimtarëve. Merhameti ose mëshira do të ketë kuptim atje ku pala armike duhet zbutur, ku mund të arrihet ndikim pozitiv. Sepse, loti i zalimit është si loti i qebapit i cili fërgohet në zjarr. Nëse ki mëshirë ndaj zalimit (tiranit), ai do të bëhet zalim edhe më i madh. Poeti Sa’di thotë: “Nëse tregon mëshirë ndaj një tigri dhëmbëmprehtë, do të shkaktohet dëm ndaj deles të cilën do ta shqyejë më pas.”

Çfarë roli kemi në këtë botë?

Tani të kalojmë në një term tjetër. Çfarë duhet të jetë roli ynë në këtë botë? Kjo, sipas sistematizimit tim, afërsisht, do të përkufizohet në ngritje dhe rënie të njeriut mysliman, familjen e tij, rrethin e tij të gjerë dhe komunitetin e tij në përgjithësi.

Më herët kemi theksuar se në kuptimin e njohjes së atyre fakteve të vërteta, realiteteve të kësaj dhe botës tjetër, Kurani posedon dy lloj ajetesh: disa e trajtojnë si qenie superiore, kurse të tjerët si qenie më e ulët – më ulët se shtazët, andaj tek disa



paraqitet dyshimi për një kontradiktë në Kuran. Në bazë të kësaj, paraqitet pyetja kush jemi ne në Univers dhe çfarë është roli ynë, detyra jonë në të. a është e qartë teza jonë si insan krijesë humane, ngase ne “jemi bërë” ashtu që qoftë në çështjet ideore, morale ose materiale, gjithnjë synojmë drejt një favorit dhe dëshirojmë ta përparojmë veten në këtë drejtim.

Çka mund të themi për atë që ka kryer vetëvrasje? A e ka bërë ai këtë për të siguruar ndonjë dobi apo për ta dëbuar ndonjë dëm? Ta marrim shembull që dikush ka varë veten. Përse e ka bërë këtë? Për të ikur nga e keqja nga rrethi i tij dhe me këtë të shpëtojë nga vuajtjet e kësaj bote. Të gjitha hulumtimet tona që nënkuptojnë edhe disa patente, janë në gjurmë të interesave tanë. Këtë temë do ta vazhdojmë duke prezantuar disa argumente kur'anore dhe burhan –ore (logjike).

Kur është fjala për njohjen, nuk do të merremi me njohjen e arifëve, eremitëve, të cilët rrinë ulur në një kënd të errët dhe bëjnë ibadet; kjo është jashtë interesimit të asaj çka do të trajtojmë këtu, por nuk do të merremi as me tezat materialiste dhe komuniste sipas cilave njeriu është epiqendër dhe bosht i çdo gjëje në këtë botë. do të merremi më shumë ato çështje të cilat na interesojnë, me Librin e Zotit që na është dhënë dhe që na trajton, të shohim si janë shprehur përmes saj përgjigjet për pyetjen kush jemi ne në të vërtetë.

Do të ishte tragjedi e vërtetë që ne si studiues të mirë, pas shumë mundimesh dhe përpjekjesh dhe suksesi material, në pyetjen kush jemi ne, të kemi përgjigje të njëjtë si një dele. Nëse dikush na pyet kush jemi ne dhe ku qëndron domethënia e jetës sonë, do të themi jemi të shëndoshë, se hamë mirë, flemë mirë, i shprehim me sukses pasionet tona, si dhe dëbojmë me sukses armiqtë tanë nga ambienti ynë. Nëse e pyesim dashin cila është domethënia e jetës së tij, ai do të përgjigjej se ka bar të mirë, se kullot mirë, shpreh pasione dhe e dëbon me sukses secilin që e rrezikon mjedisin e tij. Prandaj, përgjigje e njëjtë si edhe përgjigja e njeriut. Prandaj jemi këtu që kësaj pyetje kuranore t'i përgjigjemi në mënyrë të duhur. Këtë nuk do ta bëjmë në mënyrë mekanike, porse nga pikëpamja e aklit, si fakt universal, i cili konkluzionet e përgjithshme do t'i nxjerrë nga Libri Hyjnor!

Ademi dhe domethënia e krijimit

Fillimisht do të shqyrtojmë ajetet të cilët njeriun e prezantojnë si qenien më të përsosur. Në ajetin 30 të sures El-Bekare thuhet:

Kur Zoti yt u tha engjëjve: “Unë do të caktoj në tokë një mlekëmbës!” Ata thanë: “Si mund të jetë mlekëmbës ai që shkakton çrregullime dhe derdh gjak? Kurse ne të madhërojmë dhe lavdërojmë (bëjmë tesbih) dhe të adhurojmë siç e meriton!” Ai tha: “Unë di atë që ju nuk e dini!”

Sociologët kanë një emër për këtë ide. Ata e quajnë atë "teza e sekularizimit". Tani, hulumtimet sugjerojnë se historia është më e ndërlikuar.



Në 1822, **Thomas Jefferson** sugjeroi një version të hershëm të tij, duke parashikuar se unitarianizmi "do të jetë, për një kohë të gjatë, feja e shumicës nga veriu në jug". Disa të dhëna nga vendet moderne mbështesin tezën.

Pesëdhjetë vjet më parë, rreth 4 nga 10 fëmijët në Angli ndoqën shkollën e së dielës kurse sot është vetëm rreth 10%. Në vitin 1972 në Shtetet e Bashkuara, 95% raportuan rreth përkatësisë së tyre fetare dhe vetëm 5 % e popullsisë nuk raportuan rreth përkatësisë fetare. Në vitin 2016, 1 nga 4 thanë se nuk kishin përkatësi fetare.

Hulumtimet e fundit, megjithatë, kanë sugjeruar se feja është më e qëndrueshme se sa ishte menduar më parë. Përderisa pjesëmarrja në kishë ka rënë ndjeshëm në Evropën Perëndimore, sekularizimi ka qenë më pak i dukshëm në Shtetet e Bashkuara. Numri i amerikanëve që e rendisin përkatësinë e tyre të kishës si "asnjë" është rritur, por më shumë se 70% ende e identifikojnë përgjithësisht si të krishterë.

Konsensusi i ri i sociologëve dhe demografëve është se modernizimi dhe sekularizimi janë vërtet të lidhura, por në mënyra komplekse.

Një studim i publikuar këtë javë nga Qendra Kërkimore e Pew mbi marrëdhënien në Shtetet e Bashkuara midis religjionit dhe nivelit arsimor (një komponent i modernizimit, së bashku me ndryshimet teknologjike dhe të tjera) në shikim të parë duket të mbështesë tezën e sekularizimit: Sa më shumë njerëz të arsimit, aq më pak fetare janë.

"Të diplomuarit e kolegjit kanë më pak gjasa të thonë se besojnë në Zotin me siguri absolute", vuri në dukje studiuesi kryesor Pew Gregory Smith. "Ata kanë më pak gjasa të thonë se feja është shumë e rëndësishme në jetën e tyre. Ata kanë më pak gjasa të thonë se luten rregullisht dhe të diplomuarit e kolegjit kanë më shumë gjasa se të tjerët të identifikohen si ateistë dhe agnostikë".

Një vështrim më i afërt i të dhënave, megjithatë, ofron një pamje më të nuancuar. Ndërsa çifutët me arsim të lartë kanë tendencë të jenë më pak të vëmendshëm sesa çifutët më pak të arsimuar, raporti ndërmjet edukimit dhe besimit fetar është

Pse feja është më e qëndrueshme

Gjersa shoqëritë bëhen më moderne, feja humbet kontrollin e saj. Njerëzit e ndajnë



më i dobët mes atyre amerikanëve me një identitet të fortë kristian.

Rritja e mprehtë e numrit të amerikanëve që nuk raportojnë lidhje fetare mund të ketë gjithashtu një shpjegim që nuk lidhet me sekularizimin. Hulumtimet nga Philip Schwadel në Universitetin e Nebraskës thonë se është më pak e pranueshme 50 vjet më parë të identifikohesh si jo-religjioz se sa është sot, pra ishte më e vështirë të ishe i pa fe në atë kohë se sa është sot.

Schwadel dhe të tjerë gjithashtu argumentojnë se ka dallime të konsiderueshme midis Shteteve të Bashkuara dhe Europës kur bëhet fjalë për procesin e sekularizimit. Në Evropë, feja e organizuar në përgjithësi është shoqëruar me qeveritë në

se mendimi i zakonshëm në shoqërinë moderne?

fenë e tyre nga institucionet e tyre dhe nga pjesët e jetës së tyre.



një shkallë shumë më të madhe se sa në Shtetet e Bashkuara. Si rezultat, ndjenja anti-qeveritare mund të ketë qenë më e mundshme në Evropë për të prodhuar antagonizëm ndaj kishës. Mbështetja e qeverisë për fenë në shumë vende të Evropës Perëndimore mund të ketë dobësuar vitalitetin e atyre komuniteteve të kishës.

"Kur një shtet krijon një marrëdhënie me një fe, udhëheqësit fetarë nuk kanë më një nxitje të njëjtë për të dalë dhe për t'i bërë njerëzit të ngazëllyer", tha Schwadel. "Ata marrin para nga shteti përmes taksave, kështu që ata nuk duhet të mbledhin para nga kongregantët e tyre".

Në Shtetet e Bashkuara, në të kundërt, udhëheqësit fetarë duhet të "nguten" më shumë, tha Schwadel.

"Ata duhet të marrin më shumë kongregacione nëse kisha e tyre do të mbijetojë." Ndoshta si rezultat, amerikanët janë më të angazhuar se evropianët në kongregacionet e tyre të kishave.

Nocioni se besimi dhe praktika fetare kanë evoluuar me modernizim, mbeten pjesërisht të pranuar. Me rritjen e shkrim-leximit dhe njohurive shkencore të avancuar, shpjegimet e mbinatyrshme për zhvillimet në botën natyrore janë bërë më pak të rëndësishme. Megjithatë, feja ka mbijetuar, argumenton Schwadel, sepse ajo luan rol të ndryshëm.

"Feja u siguron njerëzve shumë më shumë sesa thjesht shpjegime për botën natyrore", tha Schwadel. "Ai siguron komunitetin, i siguron ata me miq, i siguron mbështetje psikologjike dhe mbështetje ekonomike, dhe siguron shumë më tepër sesa thjesht një kuptim se ku janë në botë në lidhje me jetën e përditshme".

Një studim i vitit 2016 zbuloi se më shumë amerikanë kanë raportuar ndjenja në rritje të "spiritualitetit", madje duke thënë se ata ishin më pak të lidhur me fenë e organizuar. Në masën që kishat i përgjigjen kësaj nevojë, ata ndoshta do të kenë shanse më të mira për mbijetesë.

Pyetja që udhëheqësit fetarë dhe sociologët e fesë përballen është nëse modernizimi përfundimisht do të çojë në sekularizim në Shtetet e Bashkuara dhe në vende të tjera, ashtu siç ka në Evropën Perëndimore. Disa argumentojnë se një theks i zvogëluar në doktrinën tradicionale për kuptimin e shpëtimit, për shembull, ose ekzistenca e qiellit dhe ferit, është thjesht një shenjë e hershme e laicizmit në rritje.

Ndër pesimistët për të ardhmen e fesë është shkrimtari Rod Dreher, libri i ri i të cilit është "Opzioni Benedikti" përshkruan një strategji mbijetese për të krishterët "në një komb pas krishter".

"Unë jam duke shkuar në kolegje të ndryshme, katolike dhe ungjillore, duke dhënë fjalime, dhe në çdo një nga këto kolegje, profesorët më tregojnë të njëjtën gjë," tha Dreher. "Fëmijët janë fëmijë të mirë, por ata vijnë nga familjet [dhe] kishat lokale dhe ministrat e të rinjve, duke mos ditur pothuajse asgjë rreth besimit historik të krishterë".

Dreher tani është i bindur se Shtetet e Bashkuara "janë në të njëjtën rrugë rënës në drejtim të respektimit të fesë që Evropa ka qenë për një kohë të gjatë".

*"Është e gjitha për emocion," tha ai.
E huazuar nga Interneti.*



Këshilla për gratë e lënduara

ata do të përpiqen që të të thyejnë...

Është e mrekullueshme se si je e gatshme të japësh çdo gjë nga vetja në marrëdhëniet e tua me njerëzit. Është i pabesueshëm fakti se bujaria jote kurrë nuk zvogëlohet, edhe pasi je lënduar herë pas here.

Nuk ka shumë nga ata që kanë kurajën për të bërë një hap të verbër besimi për dashurinë, sepse kanë shumë frikë nga dhimbja.

Ti je përpjekur gjithmonë për të parë më të mirën tek secili që takon. As detaji më i vogël nuk i shpëton syrit tënd.

Ti je e gatshme t'i sjellësh në vëmendjen tënde dhe të kujdesesh për të gjithë ata që ndihen të lënë mënjanë. Pa pasur rëndësi se sa të meta kanë ato, ti je gjithnjë e gatshme t'i pranosh.

Je e gatshme për të marrë përsipër barrën e shërimit të atyre që janë të humbur dhe të vrarë në shpirt, sepse ti beson se ata me të vërtetë mund të shërohen, por është ky besim i yti ai që të bën një objektiv të lehtë për të tjerët.

Gjithmonë do të ketë njerëz që do të të vihen kundër pa marrë parasysh se sa ke bërë për ta. Ti u jep atyre gjithçka që ke dhe atë gjithçka do të ta kthejnë të vrarë e të thyer. Ata do të marrin gjithçka prej teje derisa ti të mbetesh një guaskë bosh.

Ata do të përpiqen që të të thyejnë në po atë mënyrë që bota i ka thyer ata.

Do të jepja çdo gjë që kam që të mundja të thoja me plot besim se nëse mbetesh ai njeri i dhembshur që je, bota do të të japë një lloj dashurie që do të të bëjë të ndihesh si një mbretëreshë.

Por nuk dua të të jap shpresa të tilla të rrema si kjo. Bota është e mbushur me shpirtra monstruoze

që nuk kujdesen për të tjerët. Ti je bujare ndaj një gabimi dhe kështu nuk do të refuzosh që të mos falësh edhe të tjerë.

Por kjo do të thotë se para tyre ti je si një pre e pafuqishme. Do të duhet të lëndohesh disa herë, përpara se të gesh atë që është i duhuri për ty.

Kujdes , ata do të luajnë rolin e viktimës.

Do të njohësh dhe do të biesh në dashuri me disa meshkuj të cilët do të përpiqen që të të manipulojnë, duke të bërë të mendosh se tek ti ka diçka që nuk shkon.

Ata do të luajnë rolin e viktimës në rastin më të parë dhe do të bëjnë të ndihesh tmerrësisht keq. Këta njerëz do të të rrotullojnë me gishtat e tyre dhe do të të mbajnë të varur me premtimet se do të bëhen më të mirë. Por e gjithë ajo çfarë do të merrni janë disa copëza dashurie dhe keqardheje përpara se ata të bëhen të urreyeshëm sërish.

Kuptojeni se asnjë nga këto meshkuj nuk do të shndërrohet në të dashurin të cilin ke kërkuar gjatë gjithë jetës. Ata do të sillen sikur meritojnë të gjitha të mirat prej teje dhe për shkak se ti kujdesesh për të tjerët gjithmonë, ti do t'u japësh atyre çdo gjë që ata kërkojnë.

Por asnjë prej tyre as që do ta marrë mundimin që të qëndrojnë në jetën tënde përgjithmonë. Nuk do të jenë aty kur ti të kesh nevojë. Do të shkojnë dhe të vijnë sa herë të duan, sepse ata të duan për aq kohë sa kanë interes që të të kenë.

Do të jetë e lehtë të ndjeni për ta, sepse ata do të të thonë gjëra të bukura që do të të tërheqin si bletën në mjaltë. Ata do të të mbulojnë me komplimente të ëmbla, por të rreme dhe çdo fjalë që ata do të thonë do të nxitet nga ndonjë motiv tjetër që është i dëmshëm për ty.

Ata do të bënin çdo gjë që të të bëjnë ty që t'i duash. Ata do të të detyrojnë të besosh se kanë rënë në dashuri kokë e këmbë me ty, por të themi të vërtetën, ata thjesht po kërkojnë që ti t'u japësh çdo gjë që ata duan. Ata nuk munden dhe nuk do të ta japin atë ndjenjën paqësore që po kërkon, ata thjesht do të të stresojnë dhe do të të bëjnë të ndihesh çdo ditë e më shumë e pasigurt.

Nuk është e lehtë të jesh personi që je!

Do të duket sikur nuk përfiton asgjë nga të qenit e mirë me të tjerët. Por qëndro e fortë dhe këmbëngulëse. Kur e gjithë kjo të ketë përfunduar, do të jesh ti fituesja.

Ata që të lëndojnë dhe janë të gatshëm për të ta kthyer shpinën, janë ata që do të përfundojnë me humbje më të mëdha nga sa mund ta kishe menduar. Do të vijë një kohë kur do të takosh një person i cili do të jetë shpërblimi yt përfundimtar. Ai do të eklipsojë të gjithë këta njerëz të tmerrshëm që të kanë lënduar aq shumë.

Ti do të mësosh se çfarë do të thotë me të vërtetë dashuria dhe më në fund do të marrësh të gjitha gjërat e mrekullueshme që Zoti ka ruajtur për ty. Mund të mos jesh e përkryer, por ti je e butë dhe e dhembshur dhe ke bërë më të mirën që mund të bëje, që njerëzit që të rrethojnë të rriten në versionet më të mira të vetes së tyre.

Vazhdo t'i tregosh vetes se je e bukur, sepse kjo është e vërteta. Mos lejo që ata të shkatërrojnë gjithçka që ke punuar kaq shumë për ta ndërtuar. Kurrë mos lejo që ata të zbehin dashurinë që ke për veten tënde. Mos harro se je e mrekullueshme dhe sigurisht, atëherë kur më pak e pret, do të marrësh dashurinë që e meriton.

E huazuar.



Mrekullia

e Zotit për numrin 19 në Kur'an

Mrekullia e numrit 19: Kjo fage është dedikuar për të shpërndarë të vërtetën për mesazhin universal të Zotit në Matematikë-dorëzimin absolut të shpirtit dhe dedikimin tek Zoti. Kjo është urdhëresa fillestare në të gjitha shkrimet e Zotit, përfshirë Testamentin e vjetër, Testamentin e ri dhe Testamentin e fundit.

Ashtu sikurse vetë Kur'ani edhe kodi matematikor i Kur'anit varion nga shumë e thjeshta deri në shumë kompleksen. Faktet e thjeshta rreth kodit matematikor të Kuranit për numrin 19 janë vëzhgimet të cilat mund të vërtetohen pa përdorur asnjë mjet. Faktet e komplikuar kërkojnë përfshirjen e një kalkulatori ose të një kompjuteri.

• Mrekullia e numrit 19 Fakt 1

Ajeti i parë i njohur si "Bismilah" përfshinë 19 shkronja.

• Mrekullia e numrit 19 Fakt 2

Kurani përfshinë 114 sure të cilat mund të shprehen si 19×6 .

• Mrekullia e numrit 19 Fakt 3

Numri total i ajeteve Kuranore është 6346 ose 19×334 . (6234 ajetet e numeruara dhe 112 ajetet e panumëruara si Bismilah $6234 + 112 = 6346$) Kujto që $6 + 3 + 4 + 6 = 19$.

• Mrekullia e numrit 19 Fakt 4

Surja Bismilah gjendet 114 herë pavarësisht mungesës së dukshme të saj në suren 9 (kjo ndodh dy herë në suren 27) dhe $114 = 19 \times 6$.

• Mrekullia e numrit 19 Fakt 5

Nga humbja e Sures Bismilah në suren 9 deri tek shtesa në suren 27 ka saktësisht 19 sure.

• Mrekullia e numrit 19 Fakt 6

Këtu tregon se numri total i sureve nga 9-27 ($9 + 10 + 11 + 12 + \dots + 26 + 27$) është 342 ose 19×18 .

• Mrekullia e numrit 19

Fakt 7 Ky total pra 342 gjithashtu është i barabartë me numrin e fjalëve midis dy sureve Bismilah në suren 27 dhe $342 = 19 \times 18$.



• **Mrekullia e numrit 19 Fakt 8**

Zbulimi i parë i famshëm (96:1-5) përfshin 19 shkronja.

• **Mrekullia e numrit 19 Fakt 9**

Ky zbulim i parë i 19 shkronjave përfshin 76 shkronja pra 19×4 .

• **Mrekullia e numrit 19 Fakt 10**

Fillimi i sures 96 përmban 19 ajete.

• **Mrekullia e numrit 19 Fakt 11**

Fillimi i kësaj suren është në krye të 19 sureve të fundit.

• **Mrekullia e numrit 19 Fakt 12**

Sura 96 përmban 304 shkronja arabe të cilat janë 19×16 .

• **Mrekullia e numrit 19 Fakt 13**

Zbulimi i fundit i sures 110 përfshin 19 shkronja.

• **Mrekullia e numrit 19 Fakt 14**

Ajeti i parë i zbulimit të fundit përfshin 19 shkronja.

• **Mrekullia e numrit 19 Fakt 15**

“14” shkronja të ndryshme arabe nga 14 grupe të ndryshme nga inicialet kuranore janë parashtesa të 29 sureve. Këto numra japin: $14+14+29=57=.....19 \times 3$.

• **Mrekullia e numrit 19 Fakt 16**

Totali i gjithësej 29 numrave të sureve në të cilat ndodhen inicialet kuranore është $2+3+7+.....$. $50+68=882$ dhe $882+14$ (14 grupe inicalesh) janë të barabartë me 836 ose 19×44 .

• **Mrekullia e numrit 19 Fakt 17**

Ndërmjet sures së parë të inicializuar (sura 2) dhe sures së fundit të inicializuar egzistojnë 38 sure të pa inicializuara 19×2

• **Mrekullia e numrit 19 Fakt 18**

Ndërmjet inialeve të sures së parë dhe sures së fundit janë 19 grupe të alternuara të inicializuara dhe te joinicializuara.

• **Mrekullia e numrit 19 Fakt 19**

Kur’ani përmend 30 numra të ndryshëm : 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 19, 20, 30, 40, 50, 60, 70, 80, 99, 100, 200, 300, 1000, 2000, 3000, 5000, 50000 dhe 100000. Shuma e këtyre numrave është 162146 i cili është 19×8534 .

• **Mrekullia e numrit 19 Fakti 20**

Numërimi i shkronjës “K” në çdo ajet të 19 paraqitet 76 herë pra 19×4 .

• **Mrekullia e numrit 19 Fakti 21**

NUN(Noon) ky inicial është unik dhe është i përfshirë në suren 68 ku çdo shkronjë tregon një fjalë(Noon Woow Noon). Numri total i kësaj shkronje në surën e inicializuar është 133 pra 19×7 . Fakti që “N” është iniciali i fundit kuranor sjell një numër special vrojtimesh. Për shembull: numri i ajeteve nga inicialet e para kuranore deri në inicialet e fundit është 5263 pra 19×277 . Fjala Allah përfshihet 2641 herë pra 19×139 .

• **Mrekullia e numrit 19 Fakti 22.**

Hyrja fillestare janë 3 suret, 7, 19 dhe 38. Shfaqja e shkronjës ‘s’ në këto tre sure është 152 herë, pra 19×8 (e emërtuar 97, 26 dhe 29). Është e rëndësishme që në suren 7:69 fjala ‘Bastatan’ është shkruajtur në shumë piktura me një “saad”, në vend të “seen”. Ky është një shtembërim i gabuar që cënon Kuranin. Duke parë kopjen më të vjetër të Kuranit, në kopjen Tashkent, u gjend që fjala ‘Bastant’ është shkruar në mënyrë të saktë me “seen”.

• **Mrekullia e numrit 19 Fakti 23.**

Zbulimi i dokumentit që “19” është emërtimi më i zakonshëm në Kur’an u bë realitet në Janar 1974, përputhja me Zul-Hijjah 1393 A. H u zbulua në 13 B. H (Përpara Hijrah). Kjo bën që numrat e viteve nga zbulimi të Kuranit janë në zbulimin e mrekullisë $1393+13=1406=19 \times 74$. Lidhja ndërmjet 19×74 viteve hënore dhe 1974 viteve diellore nuk mund të shpejtonin vëmendjes. Kjo është veçanërisht e çuditshme për shkak të faktit se numri 19 përmendet në suren 74.

• **Mrekullia e numrit 19 Fakti 24.**

Shkronja “J” ndodhet në këtë sure 237 herë, ndërkohë që shkronja “S” (Seen) ndodhet 48 herë. Totali i shkronjave është 285, 19×15 . Është e rëndësishme që shkronja “J” është e shkruar në kuran në dy forma: njëra është e dukshme dhe tjetra si nentitull. Mënyra e formimit të shkronjës të fjalës mund të jetë konfuze për ata që s’janë të miqsuar me gjuhën arabe. Një shembull i mirë i fjalës “Araany që është përmendur dy herë në 12:36. Shkronja “J” është përdorur dy herë në këtë fjalë, “J” i parë lidhet me mprehtësinë dhe e dyta është e dukshme. Sura 36 nuk përmban asnjë shkronjë “J” të tipit që shpreh mprehtësinë. Ky është një fenomen i jashtëzakonshëm, dhe nuk mund të ndodhe normalisht në një sure të gjatë si ajo e 36.

Përktheu nga anglishtja: Jonida Haxhi



MOS E HARRO TE KALUARËN

***“Dallimi nuk është në mes të mirës dhe të keqes suaj,
por ka të bëjë me atë se sa jeni i vlefshëm në sytë
e atij që e keni përballë.”***

Na ishte njëherë një rrogëtar. Edhe pse ishte rrogëtar, ai ishte një njeri i zgjuar dhe ambicioz. Në shtëpitë ku kishte punuar, nuk kishte ndenjur kot, por kishte zhvilluar aftësitë e tij. Kur të gjithë flinin, ai ishte në këmbë. Kishte mësuar disa gjuhë të huaja, dhe kishte filluar të luaj me instrumentet më të rëndësishme muzikore të asaj periudhe. Ishte sportist i mirë. Fakti që ishte i pashëm, kjo ishte plus për të. Ishte shumë i kulturuar, pasi që në çdo shtëpi ku punoi, nuk la libër pa lexuar. Kjo kulturë e gjerë rezultonte në të folurit dhe sjelljet e tij. Falë këtyre vetive që kishte, ai u shërbente njerëzve të rëndësishëm në këmbim të parave. Emri i tij arriti deri në pallat. Pasi që punoi një kohë si kopshtar në pallat, tërhoqi vëmendjen e Sulltanit, dhe u ngrit me poste deri në Ministrinë e Punëve të Jashtme. Ngritja e shpejtë e një rrogëtari, u prit me xhelozie dhe urrejtje nga disa me eprorë perandorakë, të cilët prisnin me vite që të ngriheshin në detyrë. Ata filluan të kërkojnë shkaqe që ta largonin atë nga zemra e Sulltanit.

Rrogëtari i vjetër e kishte një zakon. Ai hynte fshehurazi në njërin nga dhomat e pallatit. Kur hynte brenda, mbyllte derën dhe qëndronte një kohë, dhe pasi dilte, mbyllte derën me çelës. Armiqtë, që të përfitonin nga kjo situatë filluan të bënin shpifje. Ata thonin se brenda fsheh xhevahire, mbase edhe ndonjë grua. Thashethemet shkuan deri në vesh të Sulltanit, i cili i besonte shumë. Sulltani e ftoi pranë dhe e pyeti për ato që kishte dëgjuar, dhe

se çfarë bënte fshehurazi në dhomë. Rrogëtari, pa dashur t'i tregojë se çfarë bënte, i tha që kishte diçka private, që i përkiste atij. Mirëpo Sulltani nuk u bind dhe tha: Menjëherë do shkojmë aty. Ne pamundësi që kundërshtonte Sulltanin, tha: Mirë, zotëri, shkojmë. Pas tyre ishin edhe thashethemexhinjtë. Kur futen në dhomë, nuk panë gjë tjetër pos një sënduku. Sulltani e urdhëroi që ta hapte dhe ta shinin se çfarë ka brenda në të. Kur Nazëri e hapi sëndukun, pavullnetshëm panë se brenda tij kishte një pale opinga te vjetra, një këmishë dhe një pallto e grisur si dhe një palë pantallona të arnuar. Sulltani i çuditur e pyeti: çka janë këto...?! Nazëri iu përgjigj: këto janë veshjet e mia që i përka-sin jetesës sime të vjetër. Për të mos e harruar të kaluarën nga kam ardhur dhe mos të llastohem, vijë çdo ditë në dhomë, i veshë, dalë para pasqyrës dhe i them vetes kështu: –Mos e harro vendin se kah ke ardhur, sepse një ditë mund të kthehesh atje. Sulltani u largua i turpëruar nga dhoma, si dhe shpifësit të mllefosur iu kthyen punëve të tyre.

***Nëse një njeri dëshiron të iu zemërojë,
do të gjejë arsye edhe nëse jeni njeriu më
i mirë në botë. Gjithashtu, edhe kur një njeri
do t'iu falë, do të gjejë justifikim edhe nëse
jeni njeriu më i keq në botë. Dallimi nuk është
në mes të mirës dhe të keqes suaj, por ka
të bëjë me atë se sa jeni i vlefshëm në sytë
e atij që e keni përballë.***

LUGET E DERVISHEVE

Në treg fiton gjithherë ai që jep, jo ai që merr.

Një ditë, njërin nga evliatë (ermish), e kishin pyetur: - Cili është dallimi mes atyre që veç e thonë dashurinë me fjalë, dhe atyre që e përjetojnë atë? Shikoni t'jua tregoj, kishte thënë evliaja. Së pari i kishte ftuar ata që nuk kanë mundur ta kalojnë dashurinë nga goja në zemër. Atyre iu kishte përgatitur një sofër. Të gjithë ishin ulur nëpër vende. Pjata me çorbë të ngrohtë kishin ardhur, dhe pas tyre edhe lugët e gjata një metër, të njohura si lugët e dervishëve.

Evliaja iu kishte vënë kusht që t'i mbajnë lugën nga fundi dhe të hanë ashtu.

- Mirë, kishin thënë dhe kishin filluar të hanë. Mirëpo ç'ishte kjo? Për shkak që lugët ishin të mëdha, nuk mundën ta dërgonin në gojë, pa e derdhur. Në fund e panë, që s'po mund te ia dilnin, dhe ishin ngritur nga sofra.

Pas kësaj, Evliaja kishte thënë: m'i thirrni ata që e njohin me të vërtetë dashurinë. Fytyrat e tyre të ndritura, sytë me dashuri, njerëz të buzëqeshur, kishin ardhur dhe ishin ulur në sofër këtë herë. Kur iu dha urdhër të hanë, secili nga i mbushte lugët e dervishëve me çorbë dhe ia zgjaste vëllait që kishte përballë. Kështu që secili e kishte ngopur tjetrin dhe ishin ngritur nga sofra duke falënderuar.

Ja pra, kishte thënë Evliaja. Kush mendon të ngopet vetëm për vetën, ai mbetet i uritur. Dhe, kush mendon për vëllain, do të ngopet ai, dhe padyshim edhe pala përballë.

Mos e harroni këtë, në treg fiton gjithherë ai që jep, jo ai që merr.

KATËR QIRINJTË

Shpresa shuhet e fundit

Katër qirinj digjeshin ngadalë. Mbizotëronte qetësi aq e madhe saqë dëgjoheshin edhe bisedat e tyre.

Qiriu i parë foli: Unë jam pajtimi. Askush nuk dëshiron që unë të rri i ndezur. E di, që do të shuhem. Pas pak çastesh, iu zvogëlua flaka, dhe u shua.

Qiriu i dytë foli: Unë jam besimi. Pothuajse askush nuk më sheh më të nevojshëm. Për këtë arsye, tash më nuk kanë nevojë për mua. Iu zvogëlua flaka, dhe u shua.

Qiriu i tretë foli: Unë jam respekti. Nuk kam forcë më të rri i ndezur. Njerëzit më kanë lënë në qoshe

dhe nuk ma kuptuan rëndësinë. Kanë harruar ta duan edhe atë që kanë pranë vetës. Edhe atij, iu zvogëlua flaka dhe u shua.

Papritmas, një fëmijë u fut në dhomë dhe pa tre qirinjtë që nuk digjeshin.

Pse nuk digjeni? Ju duhet të digjeni deri në pa-fundësi? - tha mes lotëve fëmija dhe fillojë të qajë me dënësë.

Qiriu i katërt iu kthye fëmijës dhe i tha: mos u frikëso, unë ende po digjem. Unë jam shpresa, mund t'i ndezim përsëri qirinjtë.

Fëmija, sytë e të cilit shkëlqenin, mori qiriun shpresë dhe i ndezi përsëri qirinjtë e tjerë.

Vazhdon në faqen 28



Lutjet nga Imam Zejnul Abidini a.s (Imami i Sexhades)



O Allah, caku i fundit i nevojave,
Ti je Ai tek i Cili kërkesat plotësohen,
Ti je Ai begatitë e të Cilit nuk blihen me para,
Ti je Ai i Cili nuk i prish dhuratat e Veta me
imponimin e obligimeve,
Ti je Ai me të Cilin bëhesh i pavarur e pa
të Cilin nuk je i pavarur,
Ti je Ai të Cilit dëshira i drejtohet dhe kurrë
nuk refuzohet,
Ti je Ai thesaret e kërkesës së të Cilit
nuk mbarojnë
Ti je Ai urtinë e të Cilit mjetet nuk e ndryshojnë,
Ti je Ai nga i Cili nevojat e nevojtarëve nuk refu-
zohen,
Ti je Ai të Cilin nuk e lodh lutja e lutësit,

Ti je i lartësuar me pavarësinë mbi krijesat e Tua
dhe je i denjë me pavarësinë mbi to,

Ndërsa atyre u ke dhuruar vartësinë, andaj janë
të varura nga Ti,
Kështu ai synon ta shërojë të metën e vet me atë
që është te Ti dhe dëshiron ta largojë vartësinë
nga vetja e tij me Ty, e gjen nevojën e vet në ven-
din më të favorshëm dhe e kënaq kërkesën e vet
nga vendi i vërtetë.

Mirëpo ai që për nevojën e vet i drejtohet dikujt
tjetër nga krijesat e Tua ose i përshkruan arsye

të dhurimit të tij dikujt krahas Teje, i ekspozohet
refuzimit dhe meriton mosarritjen e begatisë
Tënde.

O Allah, kam nevojë për Ty: Mundi im nuk ka qenë
i mjaftueshëm, të gjitha shkathtësitë e mia janë
sosur para se e kanë arritur. Shpirti im më shtyri
t'ia prezantoj atij i cili nevojat e veta t'i prezantoi
Ty dhe nuk bën asgjë pa Ty në kërkesat e tij, mirë-
po kjo është një
nga gabimet e atij që gabon, një nga devijimet e
mëkatarit!

Mandej, me paralajmërimin Tënd për mua erdha
në vete nga pakujdesia ime, me dhënien Tënde të
suksesit u ngrita nga devijimi im dhe me dëftimin
Tënd të rrugës u përmenda dhe u largova nga
gabimi im.

Deklarova:

Madhëruar qoftë Allahu im!

Si mund të kërkojë nevojtarin nga nevojtarin?
Si mundet ai që nuk ka gjë të kërkojë nga i varfri?
Kështu, o Allahu im, t'u drejtova me lutje dhe ta
dërgova

shpresën time me uzdajë te Ti.

Mësova se shumësia të cilën e kërkova nga Ti
është pak për begatinë Tënde,
barra të cilën e kërkova nga Ti është e dobët në



Lutja për kërkimin e nevojave nga Allahu – i Madhëruar qoftë Ai!

plotësinë Tënde, bujaria Jote nuk është prishur
nga kërkitimi i askujt, Dora Jote është më e lartë
në dhurim nga çdo dorë tjetër!

O Allah,
Prandaj bëj rahmet mbi Muhammedin
dhe familjen e tij,
më merr me mirësinë Tënde, me bujarinë
Tënde që nuk e meritoj
dhe mos më dërgo me drejtësinë Tënde
atje ku e meritoj!
Nuk jam lutësi i parë që të lutet dhe Ti i jep,
ndonëse meriton të mos i japësh.
As jam kërkuesi i parë nga Ti, të cilin e shpërblen
begatshëm, ndonëse ai meriton refuzim.

O Allah,
Bëj rahmet mbi Muhamedin dhe familjen e tij,
Përgjigju lutjes time,
dëgjoje thirrjen time,
dëgjoje zërin tim,
Dhe mos e spraps shpresën time nga Ti,
Mos e këput lidhjen time me Ty,
Mos e kthe fytyrën time në këtë nevojë timen,
Dhe nevojat e tjera nga Ti,
Për hir tim, dëgjo
përmbushjen e kërkesës sime,
përmbushjen e nevojës sime,
dhe arritjen e dëshirës sime,

para se ta braktis këtë vend,
me lehtësimin Tënd të vështirësive të mia
dhe urdhrin Tënd më të mirë për mua në të gjitha
punët!

Bëj rahmet mbi Muhammedin dhe familjen e tij
Me rahmet të përhershëm, vazhdimisht në rritje,
Vazhdimësia e të cilit nuk pushon
dhe afati i të cilit nuk ka kufi,
dhe bëje këtë ndihmë për mua
dhe arsye për plotësimin e kërkesës time!
Ti je i Pakufishëm, Dorëlidhës!
Ndërsa nevojat e mia, O Zoti im, janë të atilla dhe
të këtilla

(Këtu duhet të paraqesim nevojat personale)
Pastaj të biem në sexhde
Dhe të deklarojmë në sexhde:

Më ngushëlloi bujaria Jote,
Ndërsa rrugën ma tregoi mirësia Jote
Kështu, të lutem me Ty
Dhe Muhammedin dhe familjen e tij
- Rahmeti qoftë mbi ta!
Që të mos më kthesh të dëshpëruar!

A ËSHTË KAVANOZI I MBUSHUR?

Menaxhimi i bukur i kohës



Organizoheshin kurse për menaxhimin e mirë të kohës. Në një nga këto kurse, një profesor ekspert i menaxhimit të kohës, i pyeti nxënësit e tij: Hajde, ta bëjmë një testim të vogël. Vendosi një kavanoz të madh mbi tavolinë. Nga qesja nxori gurë, të cilët i vendosi me kujdes në kavanoz. Kur s'mbeti më vend për gurë, i pyeti se a është i mbushur kavanozi?

Të gjithë nxënësit njëzëri bërtitën: po. Profesori, u përkul dhe mori guralecë dhe i derdhi në kavanoz. E mori kavanozin në dorë dhe e tundi. Guralecët u vendosën sa djathtas e sa majtas.

Përsëri i pyeti nxënësit a është kavanozi i mbushur?

Të gjithë u përgjigjen: Jo, nuk llogaritët aq plot. Ju lumtë!- iu tha profesori. Këtë herë, poshtë tavolinës nxori një enë me rërë të imtë. Mbushi kavanozin derisa rëra u vendos mire mes gurëve. I pyeti përsëri se a është kavanozi i mbushur? Jo, nuk u mbush, bërtitën nxënësit.

Ju lumtë!- iu tha përsëri profesori. Më pas, nxori një bakall ujë dhe filloi ta derdh në kavanoz. Pastaj i pyeti se çfarë mësimi keni nxjerrë nga kjo që patë? Një nxënës guximtar nxitoi dhe tha: këtë mësim kemi nxjerrë që plani ynë ditor, sado i ngjeshur të jetë, gjithmonë mund të gjejmë hapësirë për punë të reja.

Jo, tha profesori. Ky është mësimi që duhej ta nxirnit: nëse në fillim nuk i vendosni gurët e mëdhenj në kavanoz, me vonë, nuk do të mund t'i vendosni asnjëherë.

FLETA E TRËNDAFILIT

Çdoherë ka vend për një fletë trëndafili që nuk e fundosë uji.

Një ditë, në derën e një tempulli erdhi një i huaj. I huaji rrinte në derë dhe priste. Aty bëheshim takimet me intuitë, për këtë shkak nuk kishte në derë as çekan dhe as zile. Pas disa çastesh dera u hap. Prifti budist nga brenda vështronte të huajin i cili qëndronte në derë. Pas një përshëndetjeje, filloi të flas pa fjalë. I huaji dëshironte të hynte dhe të qëndronte në tempull. Budisti u zhduk për pak çaste. Pas pak, u kthye me një bidon të mbushur me ujë deri të gryka dhe ia zgjati të huajit. Kjo do thoshte se në tempull kishte plot njerëz dhe se nuk kishte vend për një tjetër aty. I huaji u kthye në

kopshtin e tempullit, mori një fletë trëndafili dhe e lëshoi mbi ujë. Fleta e trëndafilit notonte mbi ujë dhe nuk fundosej. Prifti me përkulje dhe nderime ia hapi derën të huajit dhe e mori brenda.

Çdoherë ka vend për një fletë trëndafili që nuk e fundosë uji.

*Tregime nga MESNEVIU
Përktheu nga turqishtja Fatijona Bajraj*



Beteja me romakët në Mutah

“Ne luftojmë për ta fituar kurorën e martirit dhe jo për lavdinë e triumfit.
Ja ku e kemi mundësinë, le të mos e humbim!”

Në vitin 629, fisi Ghassan, një fis i krishterë arab, po udhëhiqej nga Shurhajli, i cili ishte princ vazal i Bizantit. Ai ishte njëri nga sunduesit që kishin marrë letër nga Muhammedi s.a.a. për ta pranuar Islamin. Asokohe, ai qëndronte në Mut'ah, një qytezë në lindje të Detit të Vdekur. Kur i dërguari i Profetit Harith bin Umajri, arriti në pallatin e tij për t'ia sjellë letrën, ai urdhëroi që të ekzekutohej.

Vrasja e Harith bin Umajrit ishte një provokim i pashembullt, sepse vrasja e lajmëtarëve, konsiderohej një krim i pafalshëm nga shumë kombe. Profeti vendosi të merrte masa ndëshkuese. Ai mblodhi një ushtri prej 3000 burrash dhe e dërgoi atë nën komandën e mikut dhe ish-skllavit të tij Zejd bin Harithes për të kërkuar shpërblim. Në të njëjtën kohë, ai krijoi një hierarki komande dhe përgjegjësie. Sikur të vritej Zejdi, atëherë komanda i kalonte Xhafer ibn Ebu Talibit dhe sikur të vritej edhe ky i fundit, atëherë Abdullah ibn Ravaha do të bëhej komandant i ushtrisë.

Kur Shurhajli e mori lajmin se një ushtri nga Medineja po i afrohej kryeqytetit të tij, edhe ai e mobilizoi ushtrinë dhe u bë gati për t'u përballur me armikun. Ai i vendosi trupat e tija në jug, jashtë mureve të Mut'asë. Trupat përbëheshin nga garnizoni romak në Mut'ah dhe nga forca të sapokrijuara të fiseve lokale. Kur myslimanët arritën dhe e panë gjendjen, e kuptuan menjëherë se do të ishte një betejë aspak e barabartë sepse armiku ishte në përparësi të bindshme në numër.

Prijësit myslimanë e mblodhën këshillin e luftës. Zejd bin Haritheja sugjeroi që menjëherë t'i dër-

gohej një lajmëtar Profetit, i cili do ta lajmëronte për pabarazinë e forcave të të dyja palëve dhe do t'i kërkonte përforsime. Por Abdullah bin Ravaha e kundërshtoi dhe tha se vendimi për të luftuar ose jo nuk varej nga numri i tyre, sepse numri ishte krejtësisht irrelevant për ta. Ai tha:

“Ne luftojmë për ta fituar kurorën e martirit dhe jo për lavdinë e triumfit. Ja ku e kemi mundësinë, le të mos e humbim!”

Abdullah bin Ravaha e mbylli diskutimin me dëshminë e tij të fuqishme dhe myslimanët u nisën për t'u përballur me armikun. Në përballjet e para, gjenerali mysliman Zejd bin Harithe u vra.

Betty Kelen historiografia e njohur në librin e saj **“Muhammedi, i Dërguari i Zotit”** e përcjellë këtë ngjarje : “ Zejdi e mori flamurin e të Dërguarit dhe u vra sakaq. Ai ishte myslimani i parë që vdiq për besimin në një tokë të huaj (“Muhammedi, i Dërguari i Zotit”).

Kush ishte Xhafer Ibn Ebi Talib ?

Profeti shpalli se në një vizion të tij, i kishte parë martirët e Mut'asë në parajsë tek rrinin

ulur mbi kolltukë dhe se Xhaferi ishte pajisur me dy krahë zogu, të stërpikur me gjak dëshmor mbi pupla. Falë këtij vizioni të Profetit, ky dëshmor u bë i njohur me titullin “Xhaferi Fluturues” ose “Xhafer-i Tajjar”. (“Pushtimet e mëdha arabe”).

Pas martirizimit të Zejd Bin Harithit komanda e ushtrisë kaloi tek Xhafer ibn Ebu Talibi, i cili ishte vëllai i Aliut, disa vjet më i vjetër se ai. Ai luftoi trimërisht për një kohë të gjatë derisa trupat e paret të ushtarëve armiq formuan një grumbull rreth tij. Por pikërisht atëherë, një ushtar romak iu afrua nga pas, e goditi me shpatë krahun e majtë të tij dhe ia këputi nga trangu. Xhaferi nuk e lëshoi flamurin dhe vazhdoi ta sulmonte ushtrinë armike. Pak më vonë, një tjetër romak e sulmoi nga pas dhe ia preu me shpatë edhe krahun e djathtë. Ky hero i patrembur e mbajti shtrënguar flamurin në nofullën e tij dhe vazhdoi të marshonte. Pasi i kish humbur të dy krahët dhe e kishte të pamundur të mbrohej, një ushtar tjetër romak u afrua dhe e



vrau me një goditje të fuqishme të topuzit. Pas vdekjes së Xhaferit, Abdullah ibn Ravaha e morri komandën e ushtrisë por edhe ai ra dëshmor.

Teksa e sulmonte armikun, Xhaferi këndonte një këngë. **Sir William Muir** e ka përcjellë kështu këngën e Xhaferit:

**Parajsë, o Parajsë!
Ç’vend i bukur pushimi!
E ëmbël është hija atje
dhe i akullt uji...
O Romë! Koh’ e belasë
sate është pranë
E ditët kur t’mbaroj
me ty e t’të hedh përtokë
afër janë...**

Kur Xhaferi u vra, trupi i tij u kthye në kamp. Abdullah ibn Umar ibn el-Khattabi, i cili ishte me

ushtrinë, thotë se i numëroi plagët në trupin e tij dhe gjeti më se pesëdhjetë plagë vetëm në pjesën e përparme. Xhaferi kishte qëndruar në këmbë kundër shpatave e shtizave të armikut edhe pasi i kishte humbur të dy krahët.

Turpi i Halid Ibn Velidit dhe ikja nga fushëbeteja

Kur të tre gjeneralët e emëruar nga Profeti ishin vrarë, myslimanët mbetën për një kohë pa prijës. Pastaj, Halid ibn Velidi që ishte në mesin e ushtarëve, e mori flamurin në dorë dhe u priu atyre. Kur ra mbrëmja, ushtritë u tërhoqën dhe kjo i dha mundësi Halidit që t’i riorganizonte ushtarët e tij. Thuhet se të nesërmen, ai i mbajti trupat në pozitë mbrojtjeje dhe kur pa se ishte e pamundur të fitonin, urdhëroi që të tërhiqeshin. Me këtë, ai arriti ta kthente në Medinë pjesën e mbetur të ushtrisë.

Kur këta ushtarë hynë në Medinë, ata u ndeshën me një “pritje” që me siguri i bëri ta harronin “pritjen” që ua kishin bërë romakët në Mut’ah. Ata u pritën nga masat e zemëruara të njerëzve, të cilët u hidhnin pluhur në fytyrë dhe mbeturina në kokë e i tallnin ngase kishin ikur nga fushëbeteja, në vend që të vdisnin në të si trima. Më në fund, Profeti ndërhyri dhe i shpëtoi ushtarët nga reagimet e popullit.



Sir John Glubb:

Kur myslimanët e mundur i afroheshin Medines, Profeti dhe banorët dolën nga qyteti

për t’i pritur. Medinasit filluan të hidhnin baltë mbi ushtarët e ikur dhe të thërrisnin: “Ju ikanakë! Ju ikët nga rruga e Zotit!” Por Muhammedi, me atë butësi të tij që dinte ta përdorte mirë, intervenoi për t’i mbrojtur.

Mëngjesin e ardhshëm në xhami, Profeti shpalli se në një vizion të tij, i kishte parë martirët e Mut'asë në parajsë tek rrinin ulur mbi kolltukë dhe se Xhaferi ishte pajisur me dy krahë zogu, të stërpikur me gjak dëshmor mbi pupla. Falë këtij vizioni të Profetit, ky dëshmor u bë i njohur me titullin “Xhaferi Fluturues” ose “Xhafer-i Tajjar”. (“Pushtimet e mëdha arabe”).

Betty Kelen

Kur ushtria u kthye në shtëpi, ai (Muhammedi) doli për t'i pritur, bashkë me djalin e Xhaferit mbi devenë e tij. Ishte ky një kthim i tmerrshëm për ata që kishin mbetur gjallë duke e ndjekur Halidin, ndërkohë që familjarët dhe të dashurit e Profetit kishin rënë në betejë. Njerëzit e Medines morën rërë dhe baltë nga toka dhe u hodhën ushtarëve duke thirrur: “Frikacakë! Ikanakë! Ju ikët nga Zoti” (“Muhammedi, i Dërguari i Zotit”).

Edhe sikur banorët e Medines të ishin keqinformuar se myslimanët qenë mundur në Mut'ah, siç pretendon Azadi, sa kohë do t'u duhej që të kuptonin se nuk ishte ashtu? Në radhë të parë, vetë ushtarët nuk i kundërshtuan qytetarët, teksa këta të fundit u hidhnin baltë, siç u përmend më sipër. Përveç kësaj, disa prej tyre ishin tepër të turpëruar për të dalë nga shtëpitë e tyre.

Ata nuk donin të dukeshin në publik nga frika se mund të kritikoheshin ose edhe të sulmoheshin nga banorët e Medines për shkak të paburrërisë së tyre para armikut. Dëshira e tyre më e madhe ishte të fshiheshin nga gjithkush.



Muhammed Husejn Hajkal

Sapo Halidi mbërriti në Medinë, Muhammedi dhe myslimanët dolën për t'i pritur. Muhammedi e mbante në krahë Abdullahun, djalin e Xhaferit, komandantit të dytë të

forcave myslimane në Mut'ah. Pasi e kuptuan si ishte puna, njerëzit filluan të hidhnin pluhur mbi ushtarët myslimanë, duke i akuzuar se kishin ikur nga fushëbeteja, duke u larguar kështu nga kauza e Zotit.

I Dërguari i Zotit u tregoi njerëzve se ata nuk kishin ikur por se me dëshirën e Zotit, thjesht ishin tërhequr për të sulmuar sërish. Por edhe përkundër këtij arsytimi të Muhammedit, njerëzit nuk donin t'i falnin ushtarët për tërheqjen dhe për kthimin e tyre. Seleme ibn Hishami, një pjesëtar i kësaj ekspedite, nuk shkonte në xhami për t'u falur dhe as që shfaqej në publik nga frika të mos e akuzonin se kishte ikur nga kauza e Zotit. Sikur këta njerëz, e në veçanti Halid ibn Velidi, të mos dalloheshin më vonë si luftëtarë të aftë kundër të njejtit armik, emri i tyre do të mbetej përgjithmonë i njollosur. (“Jeta e Muhammedit”, Kairo, 1935)

Vërtetë janë për t'u admiruar ata myslimanë që e dinin se ishin treguar frikakakë në betejën e Mut'asë dhe ndjeheshin të turpëruar nga kjo gjë. Por kishte edhe myslimanë të tjerë, disa prej tyre shokë të afërt të Profetit, të cilët ikën nga beteja jo vetëm një por shumë herë dhe kurrë nuk u turpëruan për këtë gjë. S'ka si të mos e admirojmë njeriu paturpësinë e tyre.

Për t'i shpëtuar jetët e tyre të dashura, ata iknin nga fushëbeteja dhe ktheheshin në të vetëm kur gjendja të ishte kthyer paksa në favor të myslimanëve.

Beteja e Mut'asë ishte një disfatë për myslimanët. Sa për romakët, ajo s'ishte tjetër veçse një incident i vogël kufitar. Ata i përzunë arabët në shkretëtirë dhe për ta mori fund problemi.

Marrë nga libri “Ritregim i historisë së Islamit dhe myslimanëve”, autorë Sejfid Ali Asghar Razvi

**Zejdi e mori flamurin e të Dërguarit
dhe u vra sakaq. Ai ishte myslimani i parë
që vdiq për besimin në një tokë të huaj**

(“Muhammedi, i Dërguari i Zotit”).

Njëra nga arenat e luftimit. Mutah Jordan



Përsëritja

dhe efekti pozitiv



Pejgamberi s.a.a një grup të termeve etike i ka shpjeguar duke u shërbyer me shprehje të ndryshme. Qëllimi i përsëritjes së këtyre termeve është që të lë përshtypje më të fuqishme në besimtarët. Nëse hedhim një shikim në ajetet fisnike të Kur'anit, do të vërejmë që shumë ajete përsëriten në vende të ndryshme. Bile në disa raste ajetet thjeshtë përsëriten, tekstualisht, siç është ajeti i ndershëm: **E cilat mirësi të Zotit Tuaj i mohoni?!**

Ky ajet në suren er-Rahman përsëritet 31 herë. Edhe pse secili ajet duke u përsëritur fiton rëndësi të veçantë, megjithatë nuk mund të mohohet roli i përsëritjes në rritjen e efektit në zemra. Edhe në aktivitetet e përditshme përsëritja luan rol të rëndësishëm në aspektin e fitimit të shprehive të mira apo këqija.

Është transmetuar se kur u shpall ajeti fisnik:

All-llahu ka për qëllim që nga ju, o familje e shtëpisë (së Pejgamberit) të largojë ndytësinë e mëkateve...

Pejgamberi, s.a.a., tetë muaj pa ndërprerje kishte ardhur në derë të Aliut, paqja e Allahut goftë mbi te, e kishte thënë: “Namaz! Allahu ju mëshiroftë: o familje e shtëpisë (së Pejgamberit) të largojë ndytësinë e mëkateve dhe t’ju pastrojë deri në skaj....” (Surja Ahzab 33) . Nëse Pejgamberi, paqja e Allahut goftë me të dhe familjen e tij të ndershme, çdo ditë, së paku një herë kishte shkuar në derë të Aliut, kjo do të thotë që ky veprim ishte përsëritur 240 herë. Në fakt, duket që kishte ardhur pesë herë gjatë ditës.

Hadithe dhe thënie të urta

I Dërguari i Allahut (s.a.a.): **“Dituria është prijësi i të gjitha të mirave, kurse mosdija prijësi i të gjitha të këqijave”.**

Imam Aliu (a.s.): **“Dituria është dritë e mendjes”.**

I Dërguari i Allahut (s.a.v.a.): **“Derisa te njeriu nuk plotësohen dhjetë virtyte, nuk do t’i kompletet arsyja: (...) që të mos lodhet nga të kërkuarit e diturisë derisa është gjallë”.**

Hidri(a.s.) i tha Musait (a.s.): **“O Musa, nëse dëshiron dituri, tërësisht përkushtojë asaj, sepse vërtet dituria i përket atij i cili është tërësisht i përkushtuar”.** (Kenzul-‘ummal, 44176)

Imam Aliu (a.s.): **“Dituri arrin vetëm ai që studion gjatë”.**

Imam Aliu (a.s.): **“Dijetar është ai i cili nuk lodhet nga të kërkuarit e diturisë”.**

Imam Aliu (a.s.): **“Nxënësi duhet përpjekur në arritjen e diturisë, të jetë i palodhur dhe të mos konsideron shumë atë që di”.**

Imam Aliu (a.s.): **“Ajo që i ka larguar njerëzit nga të kërkuarit e lumturisë është fakti se shpesh herë kanë parë se pak janë dijetarët të cilët punojnë në harmoni me diturinë”.**

Imam Sadiku (a.s.): **“Kur njeriu fillon të punojë diçka, duhet të jetë i vendosur në të një vit”.**

101 KËSHILLA

për lumturinë bashkëshortore

Shpresoj që shumë prej nesh ta kenë lexuar këtë ajet të bekuar ose mund ta kenë dëgjuar shpesh në çdo dasëm apo raste kurorëzimi të qifteve bashkëshortore. Mbase ne kemi medituar rreth kuptimit dhe komentimit të tij. Por fjala e Allahut të Madhëruar nuk mbaron kurrë. Ajo është aq e thellë sa nuk mund të preket. Kushdo që ka hyrë aty, ka nxjerrë dhe ka mësuar diçka të re. Nëse hedhim dritë në këtë ajet mbi fjalën “dashuri dhe mëshirë” do të gjejmë se ndërtimi i familjes sipas mënyrës që dëshiron Allahu i Lartësuar, duhet të mbështetet patjetër mbi këto dy shtylla të mëdha.

Pa dyshim, çdo familje që e humbet thelbin e dashurisë, të respektit dhe thelbin e mëshirës, kërcënohet me shkatërrim dhe nuk qëndron më si e tillë. Ajo familje shndërrohet dhe karakterizohet vetëm nga një lidhje materiale ndërmjet dy bashkëshortëve ose nga një lidhje kontrolli e njëres palë ndaj tjetres. Ndërkohë që ne themi se familja të rrethohet nga dashuria dhe respekti. Bashkëshorti shpenzon gjënë më të shtrenjtë që ka për bashkëshorten e tij dhe nuk dëshiron asnjë shpërblim. Këtë ai e bën vetëm sepse ai e do atë. Kjo dashuri mund të shtohet më shumë gjatë marrëdhënieve intime. Me kalimin e kohës lidhja të bëhet lidhje e mëshirës dhe dashamirësisë dhe jo ashtu siç mendojnë disa se martesë është “varri i dashurisë”. Kurrsesi, martesë e ndërtuar në bazë të dashurisë dhe mëshirës nuk është varr i dashurisë. Martesë e shëndetshme është ajo martesë kur bashkëshorti arrin ta ndjejë shumë të nevojshme, sesa të mendojë se nuk mund të jetojë dot pa bashkëshorten e tij goftë edhe për disa çaste pa atë. Edhe në se ndodh që për arsye dhe probleme të ndryshme njëri prej bashkëshortëve mund të sëmuret, martesë e ndërtuar mbi bazë të mëshirës, mbart ato vlera të cilat tregojnë besnikërinë e thellë mes bashkëshortëve dhe nuk ndodh që në përballje me fatkeqësi të tilla, njëri nga bashkëshortët të heq dorë nga bashkëshorti/ja i/e sëmurë, por i qëndron pranë dhe sillet me të me dashuri dhe mëshirë. Mëshira është shumë më e lartë dhe më e gjerë se

“Është prej argumenteve të Allahut krijimi nga vetë lloji juaj i palës tjetër, i grave, që ju të gjeni prehje tek ato. Në mes jush krijoi dashuri dhe mëshirë. Këtu ka argumente për njerëzit që mendojnë.”

(Surja Rum 21)

sa nocioni i dashurisë. Kështu e ka ndërtuar Islami lidhjen bashkëshortore dhe kështu e ka formuar familjen me qëllim që familjet tona të dashura të jenë bërthama e ngrohtë e shoqërisë, vatra që ndërton dhe rrit dashurinë, respektin dhe lumturinë.

Ne kemi zgjedhur këshillat më të rëndësishme, të cilat i sjell udhëheqësi i çështjeve të myslimanëve, i nderuari mendimtari Ali Khamenei për bashkëshortët para se të bëjnë lidhjen bashkëshortore me qëllim që të ndërtojnë jetën e tyre në bazë të ndërgjegjësimit shoqëror, të ndërtojnë folenë e re të familjes së shëndetshme. Përmes përcjelljes së këtyre këshillave ne synojmë të kontribuojmë në ndërtimin e një familjeje të lumtur dhe kështu të meritojmë edhe kënaqësinë e Krijuesit të kohës, të Allahut të Madhëruar.

Martesa është ligj i natyrës dhe kushtetutë e sheriatit

1- Martesa është një nga vlerat e Islamit

Pikëpamja islame buron nga Libri i Allahut të Lartësuar dhe tradita e Pejgamberit, (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), prandaj ajo sjell argumente të qarta për nxitjen dhe inkurajimin e ndërtimit të një familjeje të shëndetshme. Pikëpamja islame i jep martesës një pozitë të pashembullt. Për këtë Pejgamberi më i nderuar, (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), ka thënë: **“Nuk është ndërtuar një ndërtesë më e dashur tek Allahu i Madhëruar sesa martesë”.**

Për këtë flet edhe eminenca e tij, udhëheqësi i çështjes së myslimanëve, Sejjid Ali Khamenei. Ai ka thënë: “Tema esenciale dhe e parë është mar-

tesa, të cilën Allahu i Madhëruar e ka bërë traditë. Këtë martesë e pason natyrshmëria, e cila është një nga mirësitë dhe sekretet e Zotit si dhe një nga fenomenet prej së cilës nuk mund të distancohesh në jetën njerëzore. Allahu i Madhëruar mund t'i braktiste njerëzit dhe t'i linte të iknin, të martoheshin e të mos gjykoreshin për atë që bënin. Por i Lartësuar i ka konsideruar martesën si një prej vlerave dhe virtyteve më të çmuara. I Lartësuar thotë se ai që nuk martohet i ka humbur plotësisht ato vlera.”

3 (3 “*Khutbetul akdul mu'errikha*”, 6/10/1372 h.)

2- Metodologjia e Islamit është më e mira

Imam Ali Khamenei thotë: “Edhe te kristianët, edhe te çifutët si dhe në fe të tjera ka kriteret për martesën, por në forma të tjera, kurse Islami e ka plotësuar e ka kompletuar këtë gjë dhe i ka konsideruar ata të dy (d.m.th. burrin dhe gruan), bashkëshortë dhe fëmijët e atyre të dyve i ka konsideruar të ligjshëm.”⁴

Imam Ali Khamenei thotë: “Mënyra e martesës në Islam është ndër më të mirat se çdo mënyrë që gjendet në te popujt dhe te fetë e tjera, qoftë në premisat e saj, apo në parimet e saj apo në vazhdimësinë e saj. Të gjitha këto janë caktuar sipas interesit dhe dobisë së njeriut.

Imam Ali Khamenei thotë: “Martesat e kryera sipas udhëzimeve të feve të tjera ne i respektojmë dhe i vlerësojmë. Pra ato lidhje martesore që bëhen nëpër kisha, apo sinagoga, apo martesat te çdo popull, sido që të jetë bërë martesa, ne nuk i mendojmë si të pa vlerë. Mirëpo udhëzimet që ka përcaktuar Islami për lidhjen martesore janë më të mira, sepse Islami ka konfirmuar dhe ka garantuar se edhe burri, edhe grua ja kanë të drejta të njëjta në martesë. Në Islam ka etikë në sjellje dhe në marrëdhëniet intime mes bashkëshortëve. Veçanërisht, Islami thekson se martesa e ndërtuar mbi parime të tilla të shëndosha është rrënja e një familjeje të shëndetshme. Parimi bazë në Islam është vazhdimësia e familjes dhe lumturia e saj.”

3- Formimi i familjes është urdhër i Zotit

Imam Ali Khamenei thotë: “Formimi i familjes sipas udhëzimeve islame konsiderohet një urdhër i Zotit. Një martesë të tillë, të mbështetur në normat dhe rregullat e Islamit duhet ta kryejnë burri dhe grua. Kjo është një detyrë dhe përgjegjshmëri

përpara Allahut. Kjo nuk është përmendur në kontekstin e obligimeve sheriatike, sepse është konsideruar si mjaft e qartë, e cila nuk ka nevojë të shtjellohet e diskutohet më tej. Allahu i Lartësuar e konfirmon lidhjen e tillë martesore jo me cilësinë e saj si legjitime, por si një ngjarjeje të vazhdueshme, e cila ndikon në jetë dhe në shoqëri. Prandaj kjo lidhje martesore është përmendur si nxitje dhe këshillë për lidhjen e shëndetshme dhe të bazuar në parimet islame ndërmjet burrit dhe gruas dhe me përcëimin e ndarjes.”

4- Allahu i Madhëruar nuk e aprovon beqarinë

Imam Ali Khamenei thotë: “Nëse djali i ri, i cili ka mundësi të martohet dhe nuk martohet, apo vajza që synon martesën dhe e refuzon fejesën duke u justifikuar se akoma nuk ka ardhur koha e duhur, mendoj se ata të dy nuk janë të sigurtë për lidhjen e tyre, apo në atë çfarë thonë. Nuk ka asgjë të keqe nëse dy të rinjtë vlerësojnë instiktet e tyre seksuale dhe gjithashtu të përpiqen t’ia drejtojnë pyetjen Pejgamberit të tyre më të nderuar, Muhamed ibn Abdullahut, (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), që ai t’u përgjigjet atyre në mënyrë të qartë: **“Martesa, (nikahu), është tradita, syneti im dhe ai që largohet nga tradita ime, nuk është prej meje.”**⁷

Imam Ali Khamenei, (pastë jetë të gjatë!), vazhdon e thotë: “Allahu i Madhëruar nuk e aprovon dhe nuk e pëlqen burrin beqar dhe gruan beqare e në mënyrë të veçantë të rinjtë, të cilët nuk janë martuar. Allahu i Madhëruar e do shumë jetën sociale. Në pikëpamjen islame nuk lejohet që njeriu ta kalojë jetën e tij i vetmuar, sepse do të jetë si krijesë e huaj në strukturën njerëzore. Islami dëshiron që familja të jetë qeliza e vërtetë e shoqërisë dhe jo individ i vetmuar.”

5- Martesa në kohën e duhur

Prej traditës së Pejgamberit, (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), është martesa në kohën e duhur.

Imam Ali Khamenei thotë: “Ne kemi një transmetim të njohur se Pejgamberi, (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), ka thënë: “Martesa është tradita ime”.

Sigurisht martesa është rruga e formimit dhe tradita e gjithë njerëzimit, e të gjithë popujve dhe feve. Po, përse atëherë ka thënë Pejgamberi, (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), se kjo është tradita ime? Cili është

sekreti specifik i kësaj? Mbase kjo e ka shpjegimin në konfirmimin e tepërt në Islam, ndërsa në fetë e tjera kjo nuk ka qenë.

Imam Ali Khamenei thotë: “Ju e vini re se konfirmimi islam për martesën nuk ka shembull të dytë në shkollat sociale dhe filozofitë e përhapura, as dhe në politikat në modë në botë. Islami ngulmon fort që djemtë dhe vajzat të martohen në kohën që janë të gatshme dhe të aftë për t’u martuar.” Imam Ali Khamenei thotë: “Martesa, përveç të qenit të saj një nevojë normale e natyrshme, ajo është gjithashtu, edhe një traditë fetare islame, prandaj është shumë e lehtë për dikë që të fitojë një sevap nga kjo punë të cilën ia kërkon natyrshmëria krijuese dhe nevoja.”

Imam Ali Khamenei thotë: “Martesa është një ligj i Allahut. Kur Pejgamberi më i nderuar, (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), thotë se martesa është tradita e tij, kjo do të thotë se Islami ngulmon shumë në këtë çështje. Nëse thuhet: Përse? Kjo ka lidhje me rëndësinë e çështjes, sepse martesa e realizuar sipas normave islame ka një ndikim të madh në formimin e familjes, në edukimin e njeriut, në përsosjen e tij morale dhe shpirtërore.”

Pjesë e marrë nga libri 101 këchilla për lumturinë martesore, Autor Ali Khamenei. Botoi Shoqarta Flladi







Gra të larta në kuran dhe synet

Hatixhja, bashkeshortja e nderuar e profetit Muhamëd

(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)

Hatixhja e devotshme dhe e drejtë, e ofroi të gjithë pasurinë e saj për burrin e saj të nderuar, Profetin Muhamed (paqja qoftë mbi të dhe familjen e tij). Profeti e përdori pasurinë në rrugën e Allahut të Lartësuar, Hatixhja ishte një burim i madh i pasurimit emocional dhe shpirtëror për Profetin e Islamit, që nga fillimi i martesës, deri në momentin e fundit të jetës së saj Hatixheja ishte zonja e parë që besoi në misionin profetik të Profetit të Islamit dhe një nga katër gratë më të larta në botë. Tre gratë tjera të nderuara ishin vajzat e saja (Hatixhes) e dashura Fatimja (paqja qoftë mbi të!). Hatixheja ishte simboli më i mire i nderit, i bujarisë dhe i vetësakrificës. Edhe para se të martohej më të Dërguarin e e fundit të Allahut, ajo ishte e njohur si nëna e jetimëve. Ajo e përdorte pasurinë dhe aftësinë e saj për të mbështetur të varfërit, të vejat dhe jetimët. Nuk është çudi që Profeti (paqja qoftë mbi të dhe familjen e tij) ka thënë në mënyrë të përsëritur për të, pas vdekjes se saj:

**"Allahu e bekoftë! Shembull
si ai i Hatixhes nuk mund
të gjendet askund..."**

Allahu e lartësoi pozitën e kësaj zonje në qiej."

Një karakter fisnik në gjejmë edhe te Fatime Zahraja, bija e dashur e Profetit Muhamed (paqja qoftë mbi të dhe familjen e tij) dhe e Hatixhes. Ajete të shumta të Kuranit, sipas komentuesve të njohur i janë referuar, duke e përshkruar Fatimën si një zonjë të devotshme, të dëlirë, të bindur ndaj Allahut. Ndër ato ajete përmendim. "Atyre që të kundërshtojnë ty për çështjen e Isait, pasi të ka ardhur njohuria, thuaju: "Ejani t'i thërrasim bijtë tanë dhe bijtë tuaja...." (Ali Imran",61)

Një grua e nderuar, që përmendet në Kur'an për bindjen dhe nënshtrimin ndaj urdhrave të Allahut, është Asija, gruaja e Faraonit: "Allahu ka dhënë si shembull për besimtarët gruan e Faraonit, kur ajo tha : **"O Zoti im! Ndërtoma një banesë tek Ti, në Xhenet, shpëtom nga Faraoni dhe veprat e tij dhe nga populli keqëbërës!"** (Tahrim",11)

Në suren "Kasas", ajeti 9, tregohet shpirtdhembshuria e Asijes (paqja qoftë mbi të!) ndaj profetit Musa (paqja qoftë mbi të!), kur e gjeti atë foshnjë në lum: "Gruaja e Faraonit i tha atij: "Ky (djalë) është gëzim për mua dhe për ty, prandaj mos e vrisni, sepse mund të jetë i dobishëm ose mund ta birësojmë. "Por ata nuk e dinin se çfarë po bënin."

Edhe Merjemja , nëna e profetit Isa është përmendur dhe vlerësuar me lëvdata (34 herë) në Kur'an , "Zoti e pranoi atë (Merjemen) me mendje, e bëri që të rritet mirë dhe e la nën kujdestarinë e Zekerias. Sa here që hynte Zekeria në dhomën e saj, gjente pranë saj ushqim dhe e pyeste 'O Merjeme nga të vjen ky ushqim? "Ajo i përgjigjej: "Ky është nga Allahu, se Allahu furnizon ke të doje, pa kufi ". (Ali Imran" , 37). Pastaj (kujto) kur meleket thanë : "O Merjeme! Allahu të jep lajmin e mire për një (djalë që do të lindë me një) Fjalë prej Tij: emrin do ta ketë Mësih-Isa i biri i Merjemes, do të jetë i nderuar në këtë botë dhe në tjetrën dhe një nga të afërmit e Allahut. (Ali Imran 45)

"Edhe Merjemën, të bijën e Imranit, e cila ruajti virgjërinë e saj; Në frymë Brenda saj nga shpirti ynë (shpirtin e Isait). Ajo u besoi fjalëve të Zotit të saj dhe librave të tij e ishte nga të devotshmet!" ("Tahrim",12)

Këtu nuk nënkupton adhurimin dhe lutjen e shoqëruar me modesti (ndaj Allahut). Këto koncepte kanë qenë në mesin e virtyeteve të të gjitha keto zonja të devotshmë. Ato kanë qenë në nivelet më të larta të përsosurisë dhe gjithashtu, kanë pasur pastërti unike, duke përfshirë ng atë përmuajshmëti.

Lindja e Isait (Paqja qoftë mbi të!)

Isai është i biri i Merjemes. Jeta e mrekullueshme e Merjemes tregohet në Kur'an.

Kur'ani thotë: **“Iu përgjigj: “Kështu është! Zoti yt ka thënë: “Kjo për mua është e lehtë. Në do ta bëjmë atë shenjë për njerëzit dhe mëshire nga ana Jonë. Dhe kjo është punë e kryer.”**

Ajo mbeti më barre e u tërhoq me të në një vend të largët. Dhimbjet e lindjes e detyruan atë që të shkonte te trungu i një hurmë. Ajo tha: **“Ah, sikur të kisha vdekur para kësaj (ngjarjeje) dhe të isha harruar krejt!”**

Një zë e thirri nga poshtë: **“Mos u pikëllo, se Zoti yt të ka bërë një burim uji poshtë teje! Shkunde trungun e palmës, që të bien mbi ty hurma të freskëta!, Ha, pi dhe qetësohu. Nëse vëren ndojnë njeri, i thuaj: “Unë jam betuar në të Gjithëmëshirshmin se do të agjëroj, prandaj sot nuk do të flasë me askënd.” (Surja Merjem 21-26)**

Kur njerëzit zbuluan se Merjemja ishte shtatzënë, ata filluan ta qortonin atë duke thënë: **“Babai juaj ishte njeri i mirë. Si mundet që ju të bëni një gjë kaq të shëmtuar sa të jeni shtatzënë dhe e pamartuar?!”**

Merjemja e pyeti Zotin: **“O Zot, çfarë duhet të bëjë?”** Pastaj zëri i melekut i tha asaj që të largohej nga qyteti. Atëherë Merjemja shkoi në një vend jashtë qytetit, ku ishte një pemë e tharë hurmë. Zoti i kërkoi Merjemës ta shkundte pemën. Nga pema e tharë ranë hurmat të freskëta. Nga kjo mrekulli, Merjemja u ushqye dhe e lindi fëmijën e saj. Merjemja e lindi djalin e saj larg nga sytë e njerëzve dhe më pas shkoi në mes të popullit. Ajo u qortua prej tyre. Me urdhrin e Zotit, Merjemja u tha njerëzve që t'i kërkonin fëmiut të fliste. “Ai: (Isai në djep) tha: “Unë jam rob i Allahut. Ai më ka dhënë librin që të jem. Ai më ka porositur që të falem e të jap zekat sa të jem gjallë dhe që të jem mire ndaj nënës sime dhe nuk më ka bërë të ashpër dhe të padëgjueshëm. Le të jetë paqja e shpëtimi mbi mua, në ditët që kam lindur, në ditën që do të vdes dhe në ditën që do të ringjallet!” (Surja Merjem 30-33). Në këtë mënyrë, Allahu e shpëtoi Merjemën nga akuzat e tyre në një mënyrë të mrekullueshme.

Merjemja e zgjedhura e Allahut

Në Kuran thuhet; **“O Merjeme! Bindju Allahut tënd! Bëj sexhde dhe përkulu në ruku, bashkë**

me ata që përkulen (duke adhuruar Allahun.) Këto janë lajme të fshehura që po t'i shpallim ty (o Muhamed). Ti nuk ishe i pranishëm kur ata hodhën short se kush prej tyre do të merrte në kujdes Merjemen dhe nuk ishe i pranishëm kur ata diskutonin. (Surja Ali Imran 33-34)

Merjemja fliste me melekët

Në të vërtetë Islami i ka konsideruar gratë me vlera të mëdha. Gruaja mund tu flas melekëve të Zotit, siç thotë edhe Kurani: **“O merjeme! Allahu të jep lajmin e mirë për një djalë që do të lind me një Fjalë prej Tij, emrin do ta ket Mesih – Isa i biri i merjemes, do të jetë i nderuar në këtë botë dhe në tjetrën dhe një nga të afërmit e Allahut. Ai do t'u flasë njerëzve qysh i vogël në djep, edhe si njeri i rritur dhe do të jetë nga më të mirët.” (Ali Imran 45-46).** Kjo është sepse ata thonë: **“Neve nuk do të na prek zjarri i Xhehenemit, përvep se disa ditë”. Shpifjet që bënin i kanë mashtruar ata në besimin e vet.” (Merjem 24).** Për të shmangur pjesën më të madhe të akuzave larg nga Merjemja, ngaqë ajo e lindi këtë fëmijë pa një burrë, Kurani thotë: **“Ai do t'u falsë njerëzve qysh i vogël në djep edhe si njeri i rritur dhe do të jetë nga më të mirët.” (Ali Imran 46)**

Merjemja është figura nga Zoti

Zoti ia lehtësoi shtatzëninë Merjemes. Edhe pse ishte në një kohë kur nuk kishte fruta. Këto lehtësi na e përmend edhe Kurani ku thotë: **“Shkunde trungun e palmës, që të bien mbi ty hurma të freskëta! (Merjem 25)**

Isai është i dërguari i Allahut

Lindja e Isait pa baba, kurrë nuk mund të jetë një arsye për të besuar se ai është Zoti, sepse krijimi i Ademit, është edhe më i vështirë, pasi ai nuk kishte as nënë. Fjala e parë që tha Isau kur lindi ishte: **“Ai (Isai në djep) tha: “Unë jam rob i Allahut. Ai më ka dhënë librin (Ungjillin), më ka bërë profet dhe më ka bërë të bekuar kudo që të jem. Ai më ka porositur që të falem e të jap zekat sa të jem gjallë dhe që të jem i mirë ndaj nënës sime dhe nuk më ka bërë të ashpër dhe të padëgjueshëm. Le të jetë paqja e shpëtimi mbi mua në ditën që kam lindur, në ditën që do të vdes dhe në ditën që do të ringjallet!.” (Merjem 30-33).**

ABAZ ALIU

trim me krahë

*Engjëll! që m'u qasë pranë
Nga i madhi Zot,
Pse më rrëfen Qerbelaanë?
A do të derth lot?
moj fush'e Qerbelasë!
Që më rri ndër sy,
Plot me gjak t'Ali-Abasë,
Vallë ç'është' ay?
Ç'është' ay që shkon kahuar,
Ikën si veriu,
Me dy-tri foshnja në duar?
Është' Abas-Aliu!*

(Naim Frashëri – Lulet e Verës)



Abaz Aliu i biri i Imam Aliut a.s. lindi më 4 tetor në vitin 26 hixhri hënor (648). Nëna e tij quhej Fatime apo e njohur ndryshe me epitelin Ummul Benin; ajo ishte vajza e Hezam Ibne Halid Ibne Rabije Ibne Amer Kelbi. Ai lindi si djali i Imam Aliut (pagja qoftë mbi të) modelit të përsosmërisë njerëzore. Imam Aliu a.s.pati katër djem me këtë grua të nderuar; ata quheshin: Abas, Osman, Xhafer dhe Abdullah. Abazi ishte vëllai më i madh dhe që të katër vëllezërit i kishin dhënë besën vëllait të tyre, Imam Hysenit a.s. për të cilin sakrifikuan edhe jetët e tyre në ngjarjen e Qerbelasë.

Nganjëherë Imam Aliu paqj qoftë mbi të, kur hidhte vështrimin te djali i tij, i shfaqej para syve e ardhmja e të birit; pas një buzëqeshjeje kënaqësie ndaj caktimit të Zotit, nga sytë e tij rridhnin lot. Kur bashkëshortja e tij e pyeti se pse po vajtonte, ai i tha: “Abazit do t'i presin krahët kur t'i vijë në ndihmë Hysenit”. Atëherë, për hir të dashurisë të madhe që ka Zoti ndaj tij, do t'i falë Abazit dy krahë, që të fluturojë në parajsë si xhaxhai i vet Xhafer Ibne Ebi Talib.

Në vitin 37, hixhri në luftën e Sifinit, megjithëse ishte një djalosh shumë i njomë, vetëm 14 vjeç, ai luftoi me një heroizëm dhe trimëri të pasohqe edhe në beteja të tjera. Në fushën përvëluese të Qerbelasë, kur Abaz Aliu vuri re buzët e thara dhe sytë e përplotur të fëmijëve të Imam Hysenit a.s. rrëmbeu kacakun dhe u nis për të dhënë provimin më të madh të jetës së tij. Armiku mori shenjë dhe e goditi në krahë Abaz Aliun. Trimi, si i humbi të

dy krahët nga goditja e armikut, ra nga kali. Imam Hyseni i shkoi pranë, i qëndroi mbi kokë dhe e shtrëngoi fort në gji vëllain e dashur që më pas shkoi te Zoti.

Abaz Aliu u sakrifikua në Qerbela kur ishte 36 vjeç. Dhe fitoi përjetësinë. Është provuar tashmë dhe është shprehur qartë nga filozofët dhe shkrimtarët se sakrifikimi për idealet më të mëdha njerëzore është në të vërtetë vetë përjetësia. Qerbelaja ishte kulmi i konfliktit që kishte filluar të shfaqej gjithnjë e më qartë, pasi Profeti Muhamed s.a.a. ndërroi jetë.

E huazuar.





Kush është Vexhi Buharaja?

(1920-1987)

Ishte një figurë e shquar në shumë fusha, një intelektual i veçantë në Shqipëri, atdhetar, dijetar, poet, përkthyes, shkrimtar, historian, studiues, hulumtues, njohës i dhjetë gjuhëve kryesore Lindore Perëndimore.

U lind më 12 maj 1920, në lagjen "Murat Çelepi" në Berat. Rrjedh nga një familje intelektuale, me trashëgimi të pasur, kulturore, atdhetare. Babai i tij, Ibrahim efendi, ishte hoxhë, myderriz, atdhetar, si edhe gjyshi i tij, Ismail efendi, që të dy, burra të përmendur për dituri, në berat e në tërë Shqipërinë.

Mësimet fillestare i kreu në vendlindje, në Berat. Pas kësaj i vazhdoi studimet në Medresenë e Përgjithshme në Tiranë, ku u diplomua në vitin 1940 si një nga studentët më të dalluar. Menjëherë pas diplomimit, në moshën 20-vjeçare, u punësua në redaksinë e revistës **"Kultura Islame"** (e përmuajshme fetare, diturore, artistike, letrare), organ i Komitetit Mysliman Shqiptar në Tiranë.

Në vitin 1944, u largua nga Tirana, për shkak të rrethanave të vështira të luftës dhe qëndroi në vendlindje. Në vitin 1944, u largua nga Tirana, për shkak të rrethanave të vështira të luftës dhe qëndroi në vendlindje, në Berat, tek familja e tij. Me ardhjen e komunistëve në pushtet (nëntor 1944), për pak kohë punoi në Berat si referent në Shtëpinë e Kulturës. Në vitin 1946, komunistët e burgosin, duke e akuzuar se bënte propagandë kundër qeverisë komuniste të Shqipërisë. Pasi doli nga burgu, edhe pse ishte në liri, si ish-i burgosur politik ende konsiderohej prej udhëheqësve të parisë si armik. U detyrua të bëjë punë të rënda fizike për të mbijetuar.

Vexhi Buharaja, ky njeri i rrallë, ju bëri ballë të gjitha vështërsive. Ishte dhe mbeti njeri i madh, poet, përkthyes, shkrimtar, historian, orientalist, studiues, hulumtues, fetar i mirë e atdhetar i

devotshëm. Në vitin 1965, e pranuan në Sektorin e Historisë së Mesjetës, kërkimore shkencore dhe rezultate madhështore. Puna që bëri në Institutin e Historisë i zbuloi shumë fshehtësi Shqipërisë. Vexhi Buharaja me punën e tij këmbëngulëse, kërkimore studiuese, hulumtuese e sistemuese, mblodhi, përktheu në shqip, transkriptoi rreth treqind mbishkrime turko-osmane-arabe, me vlerëmbishkrime turko-osmane-arabe, me vlerë te madhe. Ka përkthyer nga persishtja veprën **"Gjylistani dhe Bostani"** të poetit të madh Persian, **Saadi Shirazi (1203-1291).**

Përveç qindra përkthimeve të dokumenteve historike, përveç përkthimeve të kryeveprave letrare botërore, përveç përkthimeve të veprave shkencore, Vexhi Buharaja ka shkruar e botuar edhe punime, studime historike, filozofike, islamo-mistike si **Lufta e Qerbelasë, Haxhi, etj., të cilat janë botuar në revistën "Zani i Naltë", "Kultura Islame", "Njeriu" gjatë viteve 1938-1944, etj.**

Ndërroi jetë në vendlindje, në Berat, më 5 korrik 1987, në moshën 67-vjeçare, por pas tri vitesh ai sikur u ringjall në kulturën shqiptare. Pas përmbyesjes së diktaturës komuniste në Shqipëri, emri dhe vepra e Vexhi Buharasë u përtëri, hyri në histori.

Për jetën dhe veprën e Vexhi Buharasë studiues e historian organizuan sesione shkencore në Beratë e Tiranë. Më 20 dhjetor 1993, iu dha tituli **"Mësues i Popullit"** (Post mortum), kurse më 6 korrik 1994, Bibloteka e qytetit të Beratit mori emrin: Bibloteka **"Vexhi Buharaja"**. Kohët e fundit, studiuesi Ahmet Kondo botoi një monografi kushtuar Vexhi Buharasë.

Ndihmesë për nënat e reja

I drejtohem i të gjithë atyre që jetojnë në shtëpi me një nënë të re

Nëna duhet të pushojë që të jetë e aftë t'i jap fëmijës gjithë dashurinë dhe kujdesin që meriton. Kur fle fëmija, nxiteni edhe nënën që të shkojë të pushojë, se ajo mbase ndjehet në siklet të largohet.

Kur jeni në tavolinën e ngrënies dhe vjen zëri i fëmijës që nga dhoma, mos e stresoni më shumë duke i thënë "shpejt, shpejt se u zgjua", por në vend të kësaj thoni "mos u ngrit se po shkoj e shoh unë këtë herë", që edhe ajo të ketë mundësi të shijojë një vakt ngrënieje.

- Fëmijën mos e merrni në krah vetëm për ta puthur e ledhatuar, merreni nganjëherë edhe që nënës se tij t'i çlodhen krahët që e kanë mbajtur me orë ndoshta.
- Të gjithë mund të dini diçka rreth rritjes së fëmijëve, por mos u bëni të bezdisshëm duke ndërhyrë në gjithçka që bën nëna për fëmijën. Nëse i keni rritur fëmijët tuaj, sikur keni dashur, atëherë kjo është e mirë që duhet lënë dikë tjetër të shijojë këtë kënaqësi. Kur t'ju kërkohet ndihmë, jepen. Për ndryshe, mos u përzieni në çdo vendim të nënës për fëmijën e vet.
- Nëse ju vetë ende nuk keni lindur fëmijë, atëherë do ta kuptoni kur të bëheni prind se të japësh këshilla është shumë më e thjeshtë se sa t'i zbatosh ato. Lutemi për pak përmbajtje.



Sulltan Murati IV, Sulltani i Perandorisë Osmane 1623-1640, shpeshherë dilte fshehtas nëpër qytet për të parë nga afër hallet e popullit. Një mbrëmje, ai ndjeu një shtrëngim në gjoks dhe vendosi të dalë jashtë. E thirri njërin nga shoqëruesit e tij dhe së bashku morën rrugët e qytetit. Në rrugë e sipër, gjetën një njeri të shtrirë përtokë. E prekën të shtririn, por panë se ai ishte i vdekur dhe se njerëzit e tjerë po merreshin me punët e tyre. Askujt nuk i bëhej vonë për të vdekurin. Sulltani iu drejtua njerëzve, por ata nuk e njohën as që e pyetën se çfarë dëshironte.

- "Pse ky i vdekur ndodhet shtrirë përtokë dhe askujt nuk i bëhet vonë për të?"

- "Ai është një pijanec dhe kurvar!" – ia kthyen të pranishmit.

"Vallë, a nuk është ai nga ummeti i Muhammedit s.a.a.? Më ndihmoni ta çojmë në shtëpinë e tij." – u kërkoi Sulltani.

Të pranishmit e ndihmuan dhe me të arritur tek shtëpia e të vdekurit, që të gjithë u larguan. Ngelën vetëm Sulltani dhe ndihmëtarit i tij.

Kur gruaja e të vdekurit e pa kufomën e të shoqit, filloi të qajë dhe me këto fjalë iu drejtua trupit të burrit të vdekur: "Allahu të mëshiroftë, o mik i Allahut! Dëshmoj se ishe nga të devotshmit."

Sulltani i hutuar e pyeti gruan e të vdekurit: - "Si vallë e konsideron prej të devotshmëve kur njerëzit thonë gjëra të liga për të? Aq të liga sakaq askujt s'i bëhet vonë për vdekjen e tij?"

Ajo ia ktheu: - "E prisja këtë. Im shoq shkonte në tavernë çdo natë dhe blinte verë aq sa kishte mundësi. Pastaj e sillte atë në shtëpi, e derdhte të tërën dhe thoshte: "I shpëtova paksa muslimanët sot." Më pas shkonte te një prostitutë (lavire), i jepte të holla dhe i thoshte që ta mbyllë derën e shtëpisë deri në mëngjes. Pastaj kthehej në shtëpi dhe thoshte: "Sot e shpëtova një të re dhe disa besim-

tarë të rinj nga amoraliteti."

Njerëzit e shihnin atë duke blerë verë dhe duke shkuar tek prostitutat dhe rrjedhimisht flisnin për të. Një ditë prej ditësh, unë [bashkëshortja] i thashë:

- "Kur të ndërrosh jetë, nuk do të ketë njeri që të të lajë, nuk do të ketë njeri që do të ta falë namazin e xhenazes dhe nuk do të marrë pjesë askush në varrimin tënd!"

Ai qeshi dhe ma ktheu:

- "Mos ki frikë! Sulltani i besimtarëve, së bashku me të devotshmit do të luten mbi trupin tim." E Sulltani me lot në sy i tha të vejës:

- "Pasha Allahun! Ai e ka thënë të vërtetën, sepse unë jam Sulltan Murati. Nesër, do ta lajmë trupin e tij, do t'ia falim namazin e xhenazes dhe do ta varrosim." Dhe kështu ndodhi. Sulltani, dijetarët, njerëzit e devotshëm dhe masa e gjerë e popullit u lutën dhe ia falën namazin e xhenazes.

Neve i gjykojmë njerëzit nga ajo që e shohim dhe nga ajo që e dëgjojmë nga të tjerët. Ah sikur ta shihnim se çfarë fshehin ata në zemrat e tyre, fshehtësi kjo mes tyre dhe Zotit të tyre, Allahut!

"O ju që keni besuar, largohuni prej dyshimeve të shumta, meqë disa dyshime janë mëkat dhe mos hulumtoni për zbulimin e të metave të njeri-tjetrit, dhe mos përgjoni njëri-tjetrin; a mos ndonjëri prej jush dëshiron të hajë mishin e vëllait të vet të vdekur ?

Atë pra e urreni! Kini frikë nga ndëshkimi i All-llahut, e All-llahu është mëshirues, Ai pranon shumë pendimin."

[Kur'an, El-Huxhurat: 12]

Përkthim i huazuar



Zgjohu edhe Zgjohu



Ali Syla

Në agun e hershëm sapo ndriti
Rrezja e parë si shigjetë më goditi
Zgjohu gjumash, si vesë tretet jeta
Vrapo lule më lule merr mësim nga bleta

Zgjohu mbush mushkëritë me nektar sabahu
Dhe frymën përcjell, këtë dhuratë nga Allahu
I pasur është mëngjesi dhe plot begati
Lëri ëndrrat, zgjohu mblidh këtë pasuri

Zgjohu shiko diellin, mbretin e dynjasë
Si i jep gjallëri tokës dhe havasë
Shpalosë të pa dukshmen, tash e kapë me sy
Vallë sheh ti me të, apo ai me ty

Zgjohu shih natyrën si portat i çeli
Dhe gjithë mysafirët në gosti i mbledhi
Të shijojnë një çast pastaj të largohen
Se nesër për tjerët vendet rezervohen

Zgjohu hulumto dhe zbulo sekretin
Se po nuk e gjeje kot ëndërron xhennetin
Po s' mbolle që tani, frytet s' ke për t' i pa
pema e xhenetit rrënjët këtu i ka

Zgjohuni o të vdekshëm, o gafil të mjerë
Ndizne dritën e zemrës, mos rrini në terr
Shihne të vërtetën me sy të batinit
Nga batini erdhët - në batin është kthimi.

Gur i Zi

Në një kënd të Qabesë
Gjeta zemrën time
Të nxirë nga mëkatet
Thyer bërë thërrime

Ngadal me dorë e preka
Ngrohtësinë e saj ndjeva
Përtëriva beslidhjen prapë
Në vajë pastaj shpërtheva

Rreth saj tavaf bëja
Me dorë e përshendetja
Zotin për mëshirë lusja
Feniks rilindte shpresa

Shtatë rrathë rreth saj bëra
Shtatë cilësi në të zgjova
Pashë pesë harfet e fshehura
Nga gjumi i egos u zgjova

E pashë kalu-belanë
Dhe shpirtat e rreshtuar
Drita e Hakut ndriçonte
Tekbiret skishin t'pushuar

*Falënderojmë poetin tonë të dashur zotëri
Ali Syla që i ndanë emocionet dhe krijimtarinë
e tij të mrekullueshme në Revistën VLERA*

7 këshilla

për dekorimin e kuzhinës tuaj



Tej përtej hapësirës vetëm për të ngrënë dhe gatuar, kuzhina është pjesa më aktive e një shtëpie. Një pjesë e madhe e jetës tonë zhvillohet në kuzhina. Duke filluar nga pritja e miqve e mysafirëve dhe familjarëve, mund të themi se kuzhina është zemra e shtëpisë. Në qoftëse jeni duke renovuar, ridekoruar apo thjeshtë dëshironi të bëni ndryshime në hapësirën ku jetoni, inspirohuni nga këto këshilla praktike të cilat me pak mund transformojnë kuzhinën tuaj.

1. BARDHË DHE ZI

Paleta e kuzhinës tuaj mund të jetë bardh e zi dhe prapë se prapë, të jetë një kuzhinë me karakter dhe stil. Modelet e ndryshme të tapetave dhe pllakave bardhë e zi, të cilat kalojnë nga një pjesë e kuzhinës në tjetrën, apo të tillat të cilat marrin vëmendjen me volumin e tyre, bëjnë që ambienti të duket modern dhe i thjeshtë. Në qoftë se nuk keni hapësirë të mjaftueshme për dollape, përdorni raftet për të renditur ose ekspozuar enët apo aksesoret tuaj të preferuar.

2. KABINETE DINAMIKE

Harrojini muret e bardha monotone. Mbusheni hapësirën e murit me dollapë të tillë me kube ku ju mund të vendosni enët tuaja të veçanta, librat dhe

bimë të ndryshme. Mos harroni të dekoroni pjesën e pasme të kubave me letër ngjitëse me ngjyrat adekuate të cilat përshtaten me stilin e kuzhinës tuaj.

3. RREZE DIELLI NË BRENDËSI

Keni kuzhinë të vogël? Këtu do duhet të keni kujdes në planifikimin e furniturës pasi që gabimet e vogla mund të bëjnë që kuzhina juaj të duket se po ngul-fatet. Mbajeni paletën e ngjyrave sa më neutrale, nga e bardha në të hirtë. E për t'i dhënë jetë dhe pozitivitet kuzhinës, theyejeni monotoninë me elemente jo të tepruara me ngjyra të ndezura, qoftë ajo e verdhe, apo tërkiz.



4. PAMJE MONOKROMATIKE

Nëse stili juaj është i tillë, që pëlqeni ngjyrat e ndezura dhe materialet e lëmuara me shkëlqim, kuzhina e tillë është e duhura për ju. Mos keni frikë

të eksperimentoni me ngjyra, por mbani mend, elementet e kuzhinës duhet të përshtaten të gjitha me nuancën të cilën ju e caktoni.



5. SPËRKATJE ME NGJYRA

Nëse kuzhina juaj ju duket monotone nga konsistenca e një ngjyre të vetme, atëherë thyjejeni monotoninë me një ngjyrë krejtësisht të kundërt e cila i jep gjallëri hapësirës. Për të përdorur kuzhinën sa më mire, mund të krijoni varëse ku do të vendosni tiganët apo enët të cilat i përdorni më shpesh.

6. RRINI BESNIK NATYRËS

Kuzhina është një ndër pjesët më me rëndësi dhe më të ngrohta të një shtëpie. E çfarë materiale do eve të ndihemi më rehat përveç se furës druri. Material ky lehtë i gjetur në treg, aira, lehtë i përshtatur me ngjyra dhe jera.



7. KUJDESI PËR HAPËSIRAT E VEÇANTA

Mendoni përtej funksioneve primare të kuzhinës dhe konsideroni se si mund t'a zgjeroni atë dhe në pjesët tjera të shtëpisë. Kur disa hapësira prekin pjesën e kuzhinës, qoftë ajo dhoma e qëndrimit ditor, korridori apo diçka e tillë, duhet menduar të krijoni një balanc të vazhdueshëm mes tyre. Përshtatni detaje me ngjyra të njëjta, paterna të jastekëve apo perdeve, materiale te dyerve apo dollapëve. Në këtë mënyre e tërë kjo njësi e gjerë nuk do të duket mondane dhe do të përmbaj energji pozitive.





Kujtime nga fëmijëria

Ishte kohë e ftohtë. Reshjet e dëborës binin nga qielli dhe çatitë e shtëpive ishin të mbuluara nga dëbora e bardhë. Zehraja po shkonte në shkollë. Rruga ishte rrëshqitëse por në atë kohë u paraqit një vajzë e moshës së saj dhe në dorë mbante bukë. Ajo kishte blerë bukë për mëngjes. Papritur i rrëshqiti këmba dhe u rrëzua mbi dëborë. Zehraja vrapoi me nxitim dhe e ndihmoi atë. E mori bukën që i kishte rënë mbi dëborë dhe ishte lagur pak dhe ia dha vajzës në dorë. Vajza e vogël e shikoi atë me një dashuri të madhe dhe me një buzëqeshje i tha asaj: “Ju faleminderit, u treguat e sjellshme”.

Burim i pastër

Një burrë i lodhur dhe i mbuluar i tëri me pluhur, po shkonte në drejtim të burimit. Pluhuri ia kishte mbuluar plotësisht flokët dhe fytyra i dukej e bardhë. Uji i pastër i burimit ndriçonte nën dritën e qiellit dhe ndriçonte sytë e burrit. Kur arriti te burimi, u ndal dhe morri një frymë të thellë. U zhvesh dhe rrobat i vendosi pranë një dege peme. Më pas u fut në ujin e burimit. Uji i burimit, ishte i pastër dhe i freskët dhe burri ndjeu një kënaqësi trupore.

Pas pak kohe, Zehraja filloi që të buzëqeshte dhe në brendësi të shpirtit ndjeu kënaqësi. Mendja dhe zemra jonë na thotë që kundrejt çdo

mirësie dhe përkrahjeje duhet të jemi falënderues. Prandaj, në qoftë se ne falemi, ajo është për shkak të shprehjes së falënderimit tonë ndaj Zotit të Madhëruar, sado pak, kundrejt miliona përkrahjeve dhe begative të Tij ndaj neve. Mendoni sado pak rreth këtyre ajeteve Kur'anore:

-Thuaj: më tregoni, nëse uji juaj humbet në thellësi, kush do t'ju sjellë ujë mbitokësor (burimor)?

-sikur Ne të dëshirojmë, e bëjmë atë të njelmët, përse nuk falënderoni?

-Sikur Ne të dëshirojmë, e bëjmë atë të njelmët, përse nuk falënderoni?

-Sikur Ne të dëshironim, do ta bënim atë të thyer (të shkatërruar) e ju do të mbeteshit gjithmonë të habitur (duke thënë)

-...Sikur të duam, Ne e shafitim tokën me ta ose shembim mbi ta copa nga qielli...

Fatmirësisht, me mëshirën e Zotit:


-Uji mbitokësor është i rrjedhshëm mbi tokë.

-Uji i pijshëm është i ëmbël.

-Pemët lulëzojnë në stinën e pranverës

-Dhe, toka na ka ofruar vendstrehim me rregull dhe qetësi

Një ditë me dëborë



Burri doli nga uji, ishte pastruar plotësisht nga pluhuri. I pastër dhe i gëzuar u nis drejt fshatit.

Një ditë, i Dërguari (s.a.a) i dashur i Zotit u kthye në drejtim të shokëve dhe tha: “Paramendoni sikur që para shtëpive tuaja është një përrua i rrjedhshëm dhe ju çdo ditë laheni pesë herë në të. Në këtë rast a do t’ju mbetet në trupin tuaj ndonjë vend i papastër?”

Shokët iu përgjigjën: “Jo”

I Dërguari i Allahut përsëri tha: “Pesë vaktet e namazit brenda një dite kanë po këtë efekt. Me faljen e pesë vakteve të namazit brenda një nate dhe dite, Zoti i zhduk të këqijat dhe mëkatet nga trupi i njeriut dhe e pastron atë”.

Sytë e përlotur

Asnjëherë nuk e harroj. Para disa viteve kur isha në klasën e tretë dhe me shokët luaja futboll, një nga fëmijët thërriti me zë të lartë nga një rrugicë: Fëmijë! Ka humbur një fëmijë i vogël dhe është duke qarë! E ndërpreme lojën dhe të gjithë së bashku shkuam pranë saj. Pamë një vajzë të vogël që kishte flokë të zeza e të bëra gërshtet dhe sytë iu ishin skuqur nga të qarët e shumtë. Ajo ishte e lodhur vetëm përsëriste fjalët: “Nëna, nëna ime ku është?”

Unë thashë: “Ta dërgojmë atë në një xhami që me anë të autopolantit nga minarja ta shqiptojnë emrin e saj dhe ndoshta prindërit e saj mund të gjinden”. Fëmijët e pranuan mendimin tim dhe të gjithë së bashku shkuam në drejtim të xhamisë. Gjatë rrugës, njëri prej fëmijëve i bleu akullore vajzës së vogël, por ajo nuk e pranoi akulloren dhe duke qarë tha: “Unë dëshiroj nënën time!”. Me shumë vështirësi e kuptova që vajza e vogël quhej Merjeme.

Shërbëtori i vjetër i xhamisë me anë të mikrofonit disa herë tha: “Është gjetur një vajzë e vogël me emrin Merjem. Luten prindërit që sa më parë të vijnë në xhami”. Vajza e vogël qante dhe kërkonte nënën e vet, dhe në fund ajo e ndërpreu të qarët sepse nëna e saj i erdhi! Vajza vrapoi në drejtim të nënës dhe u qetësua kur e përqafoi atë.

Edhe ne gjithashtu jemi si ky fëmijë i vogël dhe gjatë gjithë jetës shkojmë pas një njeriu apo gjësendi që të gjejmë qetësi. Ajo gjë nuk mund të jetë paraja, pozita, forca, bukuria apo gjëra të tjera materiale. Sepse, një pjesë e njerëzve i posedojnë këto gjëra, por prapëseprapë nuk kanë qetësi dhe gjithnjë janë të shqetësuar e të brengosur. Në Kur'anin e Madhëruar thuhet: “Ata që besuan dhe me të përmendur Allahun, zemrat e tyre qetësohen, pra ta dini se me të përmendur Allahun zemrat qetësohen”.

Dhe, namazi është rruga më e mirë për të arritur qetësi.

Të përgatitemi për falje të namazit

Veprimi i parë për të falur namazin është marrja e abdesit. Imam Bakir (a.s.) ka thënë: “ Namazi pa abdes, nuk është namaz”

Rroba të bukura

Në kohën kur Imam Hasani (as) dëshironte të falte namazin, i vishte rrobat më të bukura. E pyetën atë: “Pse gjatë faljes namazit i vishni rrobat më të bukura?”. Imami u përgjigj: “Zoti është i bukur dhe e do bukurinë. Për këtë arsye, unë i veshi rrobat më të bukura kur falem dhe i lutem Zotit”. Gjatë faljes së namazit rrobat e falësit duhet të jenë t pastra dhe hallall, është e preferuar që rrobat të jenë me ngjyrë të bardhë dhe të pastër si dhe të kenë erë të mirë.

Yjet mbi tokë

Gjatë faljes së namazit, vendi i faljes së namazit duhet të jetë i pastër dhe hallall. Vendi më i preferuar për të falur namazin është xhamia. I Dërguari i Allahut (saa) ka thënë: “Xhamitë janë shtëpitë e Zotit mbi tokë. Ashtu sikur yjet janë ndriçues për banorët e tokës, ashtu edhe xhamitë janë ndriçues për banorët e qiellit”.

Shikimi domethënës

Personi i cili falet duhet të drejtohet kah Qabeja. Qabeja është sekreti i unitetit të myslimanëve. Kur të gjithë myslimanët e rruzullit tokësor drejtohen nga Qabeja, atëherë krijohet një pamje e bukur. Qabeja e madhëruar është shtëpia e cila ndodhet në qytetin e Mekes.

Në fillim të Islamit, kur i Dërguari i Allahut (saa) nuk ishte shpërngulur ende në Medinë, trembëdhjetë vite të tëra e falte namazin në drejtim të Bejtul Mukadesit. Pas shpërnguljes në qytetin e Medinës, populli jehud filloi që t'i ngacmonte myslimanët dhe duke i përqeshur atyre u thoshin: “ Në qoftë se feja e Muhamedit është fe e ndarë në vete, atëherë përse nuk posedon një Qabe të ndarë, por e falë namazin në drejtim të Qabesë sonë (Bejtul Mukadesit)?” Këto thënie shqetësuan pa masë zemrën e pastër të Dërguarit (saa).

I Dërguari i Allahut (saa) në mes të natës zgjohej nga gjumi, dilte jashtë nga shtëpia dhe shikonte drejt qiellit të natës. Ai ishte në pritje të shpalljes së Zotit. Një natë zbriti ajeti nga ana e Zotit xh.sh.:

✽Ne shumë herë po shohim
kthimin e fytyrës tënde kah
qielli, e Ne gjithqysh do të
drejtojmë ty në drejtim
të një kibleje (Qabeje)
që ti e do atë✽ (Sure Bekare ✽ 144).

Në vitin e parë të shpërnguljes, i Dërguari i Allahut (saa) me anë të festës së Umri Besharit kishte shkuar në mes fisit Beni Salim në pjesën perëndimore të qytetit të Medinës. Në kohën kur i kishte falur dy rekatet e para të namazit të drekës në drejtim të Bejtul Mukadesit (Qabesë së parë), zbriti urdhri i Zotit për t'u kthyer në drejtim të Qabes. I Dërguari i Allahut (saa) pjesën tjetër të namazit e fali në drejtim të Qabesë dhe që nga ajo kohë ajo u bë kibleja e përhershme e myslimanëve.

Marrë nga libri “Stina e Lulzimit”



Revistën Vlera mund ta gjeni
në të gjitha kiosket e Kosovës.



SHTËPIA BOTUESE
DIELLI PAS REVE



Të nderuar lexues!

Redaksia mirëpret përgjigjet tuaja për anketën e re të revistës Vlera

- Cili shkrim ju pëlqen më shumë ?
- Çfarë tematikisht mendoni se duhen shtuar në revistë ?
- Cila rubrikë mendoni mund të rrisë numrin e lexuesve të revistës ?

Na shkruani në:

vlera.magazine@gmail.com

DOLI NË SHITJE LIBRI "JASINI ME SHKRONJA SHQIPE"

Jasini është sure e preferuar për begati dhe mbrojtje.
Jasini është në gjuhën arabe, shqipe me përkthim dhe në gjuhën arabe
por me shkronja shqipe. Gjithashtu në fund të librit keni mësimet
të palexuara deri tani.

Librin mund ta gjeni në Bibliotekën e Institutit "Naim Frasheri"
në Prishtinë, ose ta porositni përmes e-mailit

vlera.magazine@gmail.com apo numrit 044 142 038 (Viber)

ADRESA: SHQËPIA BOTUESE "DIELLI PAS REVE"
RR. RRUSTEM STATOVCI 29 - PRISHTINË.



WE NEVER DREAM ABOUT SUCCESS
We work for it.

KURSE TË GJUHËS ANGLEZE

OFROJMË:

- Kurse Grupore
- Kurse Individuale
- Kurse Intensive
- Kurse për Komunikim

PËR FËMIJË DHE TË RRITUR

1 MUAJ GRATIS!!!

PËR PERSONIN
I CILI FTON
3 SHOKË/SHOQE
NË BRITISH
CORNER

ADRESA DHE NR KONTAKTUES NË FUND TË FAQES



TAKIME DITURIE ÇDO TË ENJËTE PREJ ORËS 18:00

Qëllimi është stimulimi i debatit rreth temave filozofike, psikologjike, letrare, mistike dhe shumë të tjerë që do të paraqitet nevoja për të diskutuar.

Diskutimi dhe pjesëmarrja është i hapur për të gjithë.



**AFËR PARKUT TË QYTETIT
RR. RRUSTEM STATOVCI NR. 25
MBI ALBI MARKET 1 • KATI 1**



**043 509 700
044 509 700**



INSTITUTI KËRKIMOR NDËRKOMBËTAR
NAIM FRASHËRI